

Procesverbal

Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt për vitin 2026 e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 27.01.2026

Rend Dite

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të zëvendësuar nga KQZ, z.Sami Mejzini, znj.Pajtesa Berisha dhe znj.Dzumida Maznikar;
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca inauguruese dhe seanca e parë e vitit 2025;
3. Propozimvendim për plotësimin me një anëtar të Komitetit për Komunitete;
4. Raporti Financiar Tetor-Dhjetor 2025 (tremujori i katërt i vitit 2025);
5. Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2025 dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026;
6. Raporti vjetor i KKSBB-së Janar-Dhjetor 2025;
7. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Propozimvendim për anulimin e Vendimit për miratimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës;
9. Themelimi i Komisionit për shqyrtimin e problemeve të furnizimit me energji elektrike;
10. Themelimi i Komisionit për hetimin e procedurave të tenderimit për tenderin e mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare; dhe
11. Eventuale.

Resul Fetahu: Të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në seancën e parë të Kuvendit të Komunës për vitin 2026! Uroj që ky mandat të na shkojë mbarë dhe mirë! Para jush është propozuar rendi i ditës, i cili përfshin çështje të rëndësishme për funksionimin e Kuvendit dhe për interesin e qytetarëve tanë. Si rekomandim nga KPF-ja që kemi mbajtur dje, e kemi anulimin e Vendimit për miratimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës. Andaj, edhe kjo pikë duhet të futet në rend të ditës. Ftoj anëtarët e Kuvendit që, në frymë përgjegjësie dhe institucionale, të kontribuojnë me diskutime konstruktive dhe në përputhje me Rregulloren e Punës, në mënyrë që vendimet që do t'i marrim të jenë në interes të përgjithshëm dhe në funksion të zhvillimit të Komunës sonë. Nëse ka ndonjë anëtar që do të diskutojë apo propozojë ndryshime lidhur me rendin e ditës, urdhëroni e merreni fjalën!

Usmen Baldzi: Përshëndetje të gjithëve. Dua t'i propozoj kësaj Kuvende që të marrë një vendim për formimin e një komisioni ad hoc, të përbërë nga përfaqësues të të gjitha subjekteve politike që kanë asamblistë në Kuvendin e Komunës së Dragashit. Ky komision do të merrej ekskluzivisht me çështjen e gjendjes së furnizimit me energji elektrike në komunën tonë. Mendoj se nuk ka

nevojë për një arsyetim të gjatë, sepse të gjithë ne këtu, ashtu si edhe qytetarët e komunës së Dragashit, jemi dëshmitarë se situata me energjinë elektrike është alarmante. Prandaj propozoj që ky komision të vizitojë menaxhmentin qendror në Prishtinë, ose që ata të ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e Kuvendit tonë, në mënyrë që të marrim informacione të qarta dhe zyrtare për gjendjen e rrjetit, kapacitetet dhe mënyrën e implementimit të furnizimit me energji elektrike. Dua të theksoj në veçanti se komuna e Dragashit është ndër komunat që rregullisht dhe në përqindje të lartë i kryen detyrimet e saj për energjinë elektrike. Për këtë jemi të njohur në mbarë Kosovën, prandaj mendoj se e meritojmë një trajtim më të mirë dhe një furnizim më të qëndrueshëm. Gjithashtu do të dëshiroja që ky Kuvend të tregojë unitet, pavarësisht dallimeve politike, dhe që së bashku të ushtrojmë presion ndaj institucioneve qendrore dhe ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime për qytetarët tanë. I lus si pozicionin ashtu edhe opozitën që ta mbështesin këtë propozim, në mënyrë që së bashku, në krye me kryetarin e komunës së Dragashit dhe me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve parlamentare, të vizitojmë institucionet kompetente në Prishtinë dhe të kthehemi me informacione të sakta dhe të verifikuara që do t'i ndajmë me qytetarët dhe me këtë Kuvend. Faleminderit.

Uran Halimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Tek rendi i ditës, siç e dini, disa herë kam bo një kërkesë, tashmë është e njohur për ata që kanë qenë edhe në legjislaturën e kaluar. Është fjala për formimin e komisionit për hetimin e mirëmbajtjes së veturave. Sepse, së fundmi e pashë edhe një tender krejt të fundit, i cili ka të bëjë me mirëmbajtjen e veturave dhe, në fakt, është marrë tash nga kompania kontraktuese, ku vlera e parashikuar e tij ka qenë rreth 80 mijë euro. Edhe pse aty kanë konkurruar tri kompani, tenderin e ka fituar kompania me çmimin më të lartë në konkurrim. Është fjala për kompaninë “Gentian Sadikaj”, i cili ka konkurruar me çmimin më të lartë dhe e ka fituar tenderin, vlera e të cilit është diku 79,508.20 euro. Edhe pse si kundër kompani ka pas Nderim Qafleshin me 33,347.80 euro, kompania tjetër pas Nderimit ka qenë “Servis Kraniqi” me 73,604 euro, ndërsa kompania e tretë dhe më e larta, edhe fituese e tenderit është kompania paraprake me 79,508.20 euro. Çka është e rëndësishme këtu, për t’ua pamundësuar marrjen e tenderit kompanive tjera, është kërkuar nga operatori ekonomik që, në këtë kontratë – realisht kur dihet që operatori ekonomik më i liri të marrë tenderin – mirëpo për t’ua pamundëuar këtyre dy kompanive janë bërë disa specifika interesante në tender, ku është kërkuar vinç hidraulik, katër copa, është kërkuar pajisje për diagnostifikim, dy copa me i pas; tjetra është pajisje për mbushjen e klimave, dy copa edhe këtu; edhe një hapësirë e garazhës është kërkuar diku me 350 metër katrorë, edhe parking për tetë automjete. Çka i vyjnë Komunës katër vinça, dy diagnoza për

vetura, dy aparate për mbushjen e klimave, edhe çka i vyn një hapësirë e garazhës prej 350 metrave katrorë, edhe tetë parkingje? Neve nuk na intereson kjo pjesë, po sidoqoftë, tenderi është më i shtrenjtë, kompania është më e shtrenjtë diku rreth 46 mijë euro. Po më intereson, kush i ka bërë këto specifika, çka i vyjnë Komunës sonë katër vinça, kur s'është patjetër me i çue katër vetura në të njëjtën kohë me u mirëmbajt, çka na duhe dy aparate të klimës, besoj që mjafton edhe një. Më herët e kemi pas Nderim Qafleshin si tenderues për mirëmbajtjen e veturave të Komunës, mirëpo kësaj kompanie nuk iu vazhdue, nuk iu dhënë tenderi për mirëmbajtje të veturave. Nëse ka pas keqpërdorime kompania paraprake, ose Nderimi B.I., është mirë me na tregue ekzekutivi, a ka pas ndonjë revieë të keqe për këtë kompani, a i kanë bërë referencë të keqe nëse nuk e ka meritue tenderin. Këtu po shihet haptas që ky tender është i kurdisur më së miri, edhe dikush duhet me marrë përgjegjësi, sepse nënshkrimi i kontratës me vlerë më të lartë prej 46 mijë euro është në dëm të Komunës sonë, të qytetarëve tanë. Andaj, i nderum kryesues, edhe ju delegatë, kërkoj që të bëhet një komision hetimor nga Kuvendi, për kontratën e kaluar – se e dini ju shumë mirë që unë kam bërë kërkesë për qasje në dokumentacion zyrtar edhe kam pranuar disa fatura të fryra, me vlera shumë të larta. Edhe, ta hetojmë keqpërdorimin, ku 80 mijë euro unë besoj që nuk janë pak. Kjo është kërkesa, këtu e kam edhe kontratën, po besoj që ajo është publike, mundeni me e marrë edhe me e kqyr. Propozoj një formim të komisionit për me hetue këtë keqpërdorim. Tjetra është që – edhe pse nuk lidhet me rendin e ditës po mundim me e vazhdue në eventuale. Faleminderit shumë!

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, siç e dini ju, kryetari ka bërë kërkesa, apele ndaj KEDS-it për rregullimin e energjisë elektrike, funksionimin e saj. Por, a bën edhe një herë me e sqarue në lidhje me çka?

Usmen Baldzi: Jam i informuar, ashtu si edhe të gjithë të pranishmit këtu, se kryetari i komunës ka reaguar shpesh në rrjetet sociale dhe ndoshta edhe para opinionit më të gjerë përmes faqes zyrtare të komunës e kështu me radhë. Kjo është për çdo lëvdatë. Edhe të gjithë ne, anëtarët e Kuvendit, që në një mënyrë apo tjetër kemi kontakte me KEDS-in, kemi reaguar, sepse situata është alarmante. Madje situata është më e rëndë se për gjendje të jashtëzakonshme në Opojë. Informacionet që kam janë të këqija, por gjendja në Gorë është edhe më e rëndë se në Opojë. Dhe kjo është e njëjta. Kërkoj formimin e një komisioni ad hoc, të përbërë nga të gjithë anëtarët e kuvendeve parlamentare të Komunës së Dragashit, nën kryesimin e kryetarit. Apelët që ka bërë kryetari, ne pajtohemi, i dimë, i pranojmë, por mendoj se nuk janë të mjaftueshme. Mendoj se ky

komision komunal duhet ta fusë këtë Kuvend në një kapitull të ri parlamentar. Të vizitojmë KEDS -un qendror, drejtorinë, udhëheqjen e KEDS -it në Prishtinë dhe t'i sjellim këtij Kuvendi një informacion të saktë, jo vetëm Kuvendit por edhe qytetarëve: çfarë po bën KEDS -i, në çfarë mënyre, pse dhe për çfarë arsye po na e bën këtë që po ndodh në terren. Pra, ky komision të shkojë në Prishtinë, ose kryetari i komunës t'i ftojë përfaqësuesit qendrorë të KEDS -it para këtyre delegatëve – në përkthim, para këtij populli – dhe të shpjegojnë se ku qëndron thelbi i problemit. Mendoj se kjo do të ishte e mirë për të gjithë të pranishmit, për të gjithë qytetarët, për të gjitha partitë, dhe nuk mendoj se është çështje politike. Nuk ka nevojë të mos pajtohem këtu. Kjo është çështje qytetare për të gjithë ne, si për opozitën ashtu edhe për pozitën. Ju lutem që propozimi im të kalojë, ta fusim në rend dite, ta votojmë formimin e komisionit – minimumi të kryejë detyra – dhe ky komision ad hoc, ne nuk kemi të drejtë të formojmë komision të përhershëm për KEDS-in, të shkojë në Prishtinë dhe t'u sjellë qytetarëve një vendim, përkatësisht një informacion. Qytetarët e dinë si i shikojmë ne apelat tona; shikoni edhe apelat e qytetarëve, të cilët flasin gjithfarë gjërash dhe, në fund të fundit, paguajnë, nëse asgjë tjetër, dhe kanë të drejtë të informohen në maksimum. Nga KEDS -i, jo vetëm nga kryetari apo nga unë.

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Lidhur me kërkesat e dy delegatëve, sa i përket kërkesës së z.Usmen Baldzi, është një kërkesë me vend, mirëpo nuk ka nevojë Asambleja me formue komision Ad hoc. Unë këtë po e marr si propozim të tij dhe unë, si kryetar i Komunës, po e formoj komisionin nga të gjitha grupet parlamentare nga një përfaqësues – edhe pse unë vazhdimisht jam në kontakt me KEDS-in, ju më keni parë edhe përmes mjeteve të informimit. Por megjithatë, pasi është kërkesa edhe është kërkesë e arsyeshme, unë si kryetar i Komunës e formoj një komision – kam këtë të drejtë – prej të gjitha grupeve parlamentare nga një, edhe do të biem në kontakt me përfaqësuesit e KEDS-it. Sa i përket kërkesës së dytë, Urani edhe në mandatin e kaluar ka bërë zhurmë për kontratën e parë, bile ka bërë edhe dezinformim këtu, ka gënjyer, i ka fry 50% e ma shumë faturat, pastaj ka dalë këtu edhe ka kërkue falje. Po të mos kërkonte falje, ne kemi pas me e padit, sepse ka dalë e ka gënjye opinionin publik me informata jo të sakta. Sa i përket kërkesës tjetër tash, për formimin e komisionit, në bazë të Rregullores, Asambleja nuk ka nevojë edhe s'mund të formojë komisione. Nëse ky dyshon, është prokuroria, le ta dërgojë lëndën në prokurori. Mendimi im është që nuk ka nevojë me formue komision.

Uran Halimi: Tash, ka gënjye, pak e ulët, se unë kam kërkue falje për shkak të gabimit teknik – ti e dish shumë mirë, edhe ju e dini shumë mirë – unë kam kërkue falje që kam gabue, e jo që kam

gënjye ose dezinformue. Unë kërkova nga kryesuesi – e di shumë mirë edhe kryesuesi qysh është situata, edhe krejt delegatët e dinë. Nuk e di pse është ky komisioni shumë me spes për ju. Le ta formojmë, të mos gjejmë kurgjo, edhe ku ka gënjye Urani delni demantone mas formimit të komisionit. Komisioni formohet për më m'demantue mu, ose për me e nxjerrë një të vërtetë, i nderum kryetar. Nëse unë gënjej, është komisioni ai që më kallxon a kam gënjye unë apo jo. Ti e dish shumë mirë se çka ka gjet unë në ato fatura. Edhe, nuk ma dhaje asnjë arsye pse është dhënë tenderi me 40 e kusur mijë euro më shtrenjtë sesa kompania më e ulët që ka konkurue. Unë e ftoj kryesuesin – për hatër të qytetarëve – është mirë me e formue një komision. Nëse nuk ka gjetje, të paktën ne e bëjmë këtë punë, paguhemi për këtë punë, le ta formojmë komisionin, ta shohim qysh është situata. Më demantoni, bre kryetar, atëherë më thoni ke gënjye. Ama tash me thënë ke gënjye, po gënjesh, është e ulët se unë me argumente fola. Edhe ma herët kam folë me argumente, përveç atij gabimi që ti e paske gjet si vegëz për me u kap edhe me m'thënë mu ke gënjye. Ta shohim kush po gënjen, hajde le ta formojmë komisionin, na këtë punë e kemi. S'ka gjetje, dal unë e kërkoi falje, paskam dyshue gabimisht, edhe jemi krejt në rregull. Qytetarët tash po e hulumtojnë, po e kqyrin çka është duke ndodhë. Ti e ke shumë të qartë atë kontratën për ndërrimin e motorit të asaj veturës që ta kanë shfrytëzue vazhdimisht, 6500 euro. Përveç kësaj – se nuk deshta me diskutue – qaty e kam një fotografi, që një autoambulancë është aksidentue së fundmi në Komunën tonë, është shkatërruar gati e tëra, rasti nuk është i deklaruar në policinë e Komunës sonë, se e kam hulumtue edhe këtë pjesë. Janë fsheh gjurmët dhe është dërguar autoambulanca me bartës të veturave në kompaninë që sapo e ka marrë tenderin. Del më thuj që po gënjej edhe për këtë. Por, kallëzimet penale kam me t'i bo. Edhe për mirëmbajtjen e veturave, edhe për fshehjen e aksidentit. Aksidentet ndodhin, po pse ta fshehim? Policia e rendit është për atë punë. Informoju qytetarët çka është duke ndodhë! Ta shohim kush po gënjen.

Usmen Baldzi: Më vjen mirë, zoti kryetar, që e keni kuptuar rëndësinë e propozimit tim, si dhe sinqeritetin dhe të vërtetën. Por, si një anëtar i vjetër-i ri i Kuvendit të Komunës së Dragashit, këto ditë kam studiuar mirë statutin, rregulloren e punës në komunë dhe ligjet për vetëqeverisjen lokale. Komuna e Dragashit, shikoni, ka dy organe: kryetarin e komunës dhe Kuvendin. Kuvendi sjell disa vendime, ndërsa kryetari, normalisht, në mënyrë autonome, si fitues i zgjedhjeve, sjell të vetat. Kërkoj që Kuvendi, zoti kryetar, të sjellë një vendim, më falni – komisioni – një vendim për formimin e komisioneve, në mënyrë që t'u ndihmojmë të gjithëve, edhe neve, edhe juve. Dhe që ju të jeni më të fortë përballë KEDS-it së bashku me të gjitha subjektet politike, që të mos ketë

dallime mes nesh. Nuk është i keq, nuk është i keq propozimi im. Nuk duhet ta merrni sikur, nëse e formon Kuvendi komisionin, ju dilni në minus. Nuk është ashtu. Ju keni reaguar në ditën e Vitit të Ri, kemi reaguar bashkë. Ja, po e them të vërtetën: unë ju kam thirrur. Dhe ju menjëherë keni reaguar. Kjo është mirë. Unë dua bashkëpunim këtu në Kuvend, sa kohë që jam këtu. Midis pozitës dhe opozitës. Dua që pozita të bashkëpunojë me opozitën, dhe anasjelltas. Ka raste kur nuk pajtohemi. Për këtë ekzistojnë votat pro dhe kundër. Për këtë ekziston shumica në Kuvend dhe për këtë ekziston opozita. Le ta bëjmë, njerëz të mirë, që në emër të qytetarëve të zgjidhim disa gjëra. Sepse energjia elektrike nuk ka pozitë dhe opozitë. Energjinë e kemi problem të gjithë. Le të përmbahemi pak më shumë ligjeve. T'i përmbahemi statutit, rregullores, ligjeve për vetëqeverisjen lokale. Faleminderit.

Bexhet Xheladini: Lidhur me kërkesën e Uran Halimit, prapë dua ta sqaroj. Asambleja Komunale nuk ka ekspertë për me e shqyrtue një tender a ka qenë i ligjshëm apo jo. Është OShP-ja, organ ligjor i cili e shqyrton këtë, por janë edhe organet e drejtësisë të cilat mund ta shqyrtojnë. Siç thajë edhe vetë, paskan konkurrue katër kompani, edhe nuk e di a janë ankuar ato apo jo. Nëse janë ankuar, i janë ankuar OShP-së. Nga vetë fakti që është nënshkruar kontrata, do të thotë se çdo gjë ka qenë e ligjshme. Kështu që, e vetmja rrugë është që, nëse ju keni dyshime, mundeni që ta procedoni lëndën në prokurori, në organet e drejtësisë edhe ato le të merren me to, sepse ata kanë eksperta që e vlerësojnë a janë zbatuar të gjitha rregullat, ligjet, sa i përket dhënies së këtij tenderi. Kështu që, edhe me rregullore nuk ka nevojë edhe s'ka të drejtë Asambleja me formue komisione. Por ju e keni rrugën e drejtë, siç keni çue plot, me dhjetëra tendera në organet e drejtësisë, por deri më tash jemi qeveri me duar të pastërta, nuk kemi pas asnjë aktakuzë, edhe asnjë i dënuar deri më sot nuk ka qenë nga radhët e zyrtarëve të lartë komunalë, por edhe nga radhët e zyrtarëve tjerë më të ulët të Komunës. Unë nuk kam nevojë me e zgjat më shumë, kështu që qiti në votim propozimet e tyre dhe vazhdojmë me punën.

Granit Rifaj: Përshëndetje për të gjithë! Në parim, në emër të Grupit, i mbështesim të dyja propozimet. Edhe kryetari e tha, për propozimin e Baldzit ne kemi qenë krejt njëzëri, si pozit, si opozitë, edhe ai ka reague me kohë. Po ndoshta nuk është kurgjo keq me e mbështet edhe me një komision të Kuvendit. Sa i përket kësaj pjesës së Uranit, unë nuk e di realisht qysh shkon, a duhet me OShP, por edhe në qoftë se duhet me e bo, për me e sqarue këtë punë, e bëjmë, nuk është problem. E dëgjova kryetarin, tha këto komisionet janë jashtë Rregullores. Në mandatin e juaj i kemi mësue komisionet hetimore, në qoftë se e dini, me rastin e një hidrocentrali që ka qenë, keni

bo komisione hetimore. Atëherë, në qoftë se ka qenë jashtë rregullave, është praktikë e juaja. Për ne, në parim janë të dy kërkesat okej. Por, të lutem, debat të mos lejojmë para se me e votue rendin e ditës. Në qoftë se ka vullnet politik, i votojmë, nuk ka vullnet politik, kush i ka votat i grah edhe vazhdojmë me punën tonë.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me hedhjen në votim të propozimeve. Propozimi i parë është futja në rend të ditës anulimi i Vendimit për miratimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 20 vota për, zero kundër dhe 1 abstenim, hyn në rend të ditës kjo pikë. Vazhdojmë me propozimin nga Usmen Baldzi. Kush është për formimin e Komisionit? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 21 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo kërkesë. Vazhdojmë me propozimin e Uran Halimit? Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 10 vota pro, 11 kundër dhe zero abstenim, nuk miratohet kjo kërkesë. Atëherë, kërkuj falje, Uran! I hedhim edhe një herë në votim të gjitha! Kush është për anulimin e Vendimit për miratimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës? Kush është kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, miratohet dhe hyn në rend të ditës kjo pikë. Kalojmë te propozimi i Usmen Baldzit. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo kërkesë. Vazhdojmë me kërkesën e Uranit. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 10 vota për, 8 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo kërkesë. Tani e qesim në votim rendin e ditës, me të gjitha pikat e propozuara të rendit të ditës. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, ku do të japin betimin anëtarët e zëvendësuar nga KQZ. Ftoj z.Sami Mejzinin që ta jap betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Sami Mejzini: Përsëndejte për të gjithë! Unë, Sami Mejzini, betohem ose deklaroj solemnisht, se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje, sipas ligjit, detyrat, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë! Faleminderit!

Pajtesa Berisha: Unë, Pajtesa Berisha, betohem ose deklaroj solemnisht, se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje, sipas ligjit, detyrat, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si

anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë! Faleminderit!

Dzumida Maznikar: Unë, Dzumida Maznikar, betohem ose deklaroj solemnisht, se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje, sipas ligjit, detyrat, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë! Faleminderit!

Resul Fetahu: Faleminderit! Urime! Tani vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga seanca inauguruese dhe seanca e parë e vitit 2025. A ka dikush me diskutue rreth procesverbaleve? Nëse jo, atëherë i qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me vota 15 pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Propozimvendim për plotësimin me një anëtar të Komitetit për Komunitete. Dua ta jap një sqarim këtu. Ka ndodhur një gabim teknik në vendim, sepse, në vend se të shënohet plotësimi i anëtarit për Komitetin për Komunitete, është shënuar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Andaj, bëhet fjalë për plotësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete. A dëshiron dikush me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë? Ftoj nga SDU që ta bëjnë propozimin e emrit për anëtar të këtij Komiteti. Nga SDU është zëvendësimi.

Dzumida Maznikar: Nga SDU propozoj vetën, Xhumida Maznikar

Resul Fetahu: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: Raporti Financiar Tetor-Dhjetor 2025 (tremujori i katërt i vitit 2025). A dëshiron dikush me e marrë fjalën?

Usmen Baldzi: Në seancën e fundit të Kuvendit të Komunës së Dragashit patëm atë pikë të rendit të ditës për të cilën unë u përmbajta pak më herët, të propozuar nga drejtori për financa dhe buxhet. U dakorduam, edhe pozita edhe opozita, që në raportet financiare të paktën të kemi sqarime më të afërta. Ne nuk jemi drejtorë, nuk jemi ekonomistë, nuk merremi me pasuri, nuk e njohim buxhetin mjaftueshëm, nuk jemi anëtarë të Kuvendit të Komunës së Dragashit. Duhet të kemi më shumë qartësi dhe shpjegime se për çka po votojmë. Këtu ka edhe anëtarë të rinj të Kuvendit që ndoshta ende nuk kanë informata të plota ose nuk pajtohen. Kam apeluar dhe është pranuar. Por sot nuk e kemi marrë materialin e korigjuar. Nuk dua që drejtori të mendojë se unë po e kritikoj vazhdimisht për arsye personale — jo. Në raportin financiar jam unë ai që, edhe një herë po e them dhe nuk do ta përsëris më: kam udhëhequr buxhetin e Komunës së Dragashit pesë vjet në koalicion me LDK-

në, nga viti 2003 deri në 2007. Dhe këtë nuk do ta them më, por duhet ta dini. Këtu, zotërinj, ka pozicione që ne thjesht nuk i njohim, nuk i kuptojmë, nuk janë të qarta, nuk janë të shpjeguara. Kjo është puna e drejtorit. Keni shërbimin, keni punëtorët. Duke qenë se ky është raport tremujor, tetor–dhjetor, dhe se së shpejti do të kemi raportin vjetor, propozoj që Kuvendi sot të mos diskutojë shumë për këtë çështje dhe të mos humbasim kohë, në mënyrë që të mos i përsërisim të njëjtat gjëra kur të vijë raporti vjetor. Mirëpo apeloj që në raportin vjetor, kur të vijë koha, të ketë shumë më shumë qartësi. Nëse ju duhet diçka, nëse mund të ndihmoj — më thërrisni.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim a ka? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2025 dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026. Sa i përket kësaj pike, që ka të bëjë me Raportin e Punës së Kuvendit, siç e dini, çdo vit, në fund të vitit, bëhet përmbledhja e punës së Kuvendit në pika të shkurtëra. Vlerësoj se lidhur me këtë Raport nuk kemi nevojë për diskutim të veçantë, pasi që ai pasqyron veprimtarinë që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar dhe legjislaturës së kaluar, dhe të cilat nuk mund të ndryshohen. Megjithatë, sa i përket Planit të Punës së Kuvendit, ju ftoj që, nëse ka dikush ndonjë propozim, sugjerim apo rekomandim për plotësim-ndryshim, apo largim të ndonjë pike, të merrni fjalën dhe t'i paraqitni ato.

Usmen Baldzi: Sa i përket Raportit, kryesues, ju keni të drejtë. Ky është vetëm një raport “në vija të kuqe”, siç thuhet, ashtu siç e di unë, dhe kjo është në rregull. Në fund të fundit, ajo ka ndodhur. Sa i përket planit të punës, nuk kam shumë përvojë, por shoh disa gjëra që Kuvendi i di mirë se çfarë duhet të bëjë. Me siguri edhe anëtarët e opozitës dhe pozitës që kanë qenë më herët e kuptojnë këtë, prandaj ndoshta do të thonë diçka më shumë. Por në këtë plan dua t'i kujtoj të gjithë të pranishmit këtu se në vitin 2026 duhet të merremi dhe të caktojmë një ditë — Ditën Kombëtare të Boshnjakëve, të caktojmë një buxhet që ai komunitet ta festojë atë ditë, dhe që flamurin kombëtar boshnjak, i cili është i njohur me të gjitha ligjet në Kosovë, ta fillojmë më në fund ta përdorim në komunën e Dragashit, pasi jemi mbi 10%.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, siç e dini, për Ditën e Boshnjakëve ekzekutivi gjithmonë bën organizime të tilla, mirëpo mundemi edhe me e shti në Plan të Punës.

Usmen Baldzi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Dragashit, lus përkthyesin të përkthejë, do të flas ngadalë që të jetë e qartë. Sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë, sipas Kushtetutës së Kosovës dhe sipas të gjitha ligjeve në Kosovë, të

gjitha komunitetet janë të njohura. Ato i kanë festat e tyre përfaqësuese. Emrat, numrat, datat i di përmendësh, i dini edhe ju. Nuk ka nevojë t'i kujtoj këtu të pranishmit. Në planin e punës së Kuvendit të Komunës së Dragashit nuk e shoh festimin e Ditës së Boshnjakëve. Unë po flas për atë ditë. Nëse ka ditë të tjera, urdhëroni, propozojini. Vetëm në plan, siç thashë, vetëm në plan të jetë. Sepse në bazë të planit më pas ndahet edhe buxheti. Qoftë 10 euro, 100 euro, duhet të jetë në plan. Ligjet e favorizojnë këtë plan dhe propozimin tim që në planin e vitit 2026 të përfshihet edhe festimi i Ditës së Boshnjakëve. Asgjë tjetër. Është plotësisht në përputhje me ligjin, nuk po e udhëzoj Kuvendin të veprojë jashtëligjshëm. Nëse ka dikush që mund të më bindë se po gabo, unë do ta tërheq propozimin. Çdo komunitet në Kosovë i ka simbolet dhe shenjat e veta. Shqiptarët, Romët, Ashkalinjtë, Egjiptianët dhe Turqit. Po ashtu edhe komuniteti boshnjak e ka flamurin e vet. Dhe unë dua që në plan të vendoset se kemi obligim si komunë që në festat kombëtare dhe në të gjitha ditët kur i shpалosim flamujt — krahas atij të Kosovës — të jetë i vendosur edhe flamuri kombëtar boshnjak. Asgjë tjetër. Gjithçka në përputhje me ligjin, gjithçka normalisht, gjithçka në mënyrë demokratike. Nëse rastësisht e gjeni diku se nuk jam në të drejtë ligjërisht, e tërheq propozimin, nuk do të mërzitem, i kuptoj gjërat. Kështu mendoj unë. Dhe nuk propozoj asgjë që do të rrezikonte bindjet tuaja politike, kombëtare apo të çfarëdo lloji tjetër.

Resul Fetahu: Faleminderit! z.Baldzi, kërkoj të ulesh në vend!

Usmen Baldzi: Kryetari, kryetari, në rregull, unë jam njeri që i kupton gjërat. Jam njeri që, kur nuk kupton, pyet, dhe jam njeri që, kur nuk kam të drejtë, tërhiqem. Këtu është kuvendi dhe më pëlqen shumë që sot, në njëfarë mënyre, po sillemi si demokratë të mirë. Unë thashë “në plan”, jo në planin e punës së Kuvendit, por ky është Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Dragashit. Në këtu nuk kemi planin e Komunës së Dragashit, por planin e Kuvendit të Komunës. Nuk kam thënë që në këtu të thërrasim një seancë me rastin e Ditës së Boshnjakëve. Jo, nuk e kam menduar këtë. Mirë, ku ta propozoj unë atëherë? Po ju pyes: atëherë ku ta propozoj unë që për Ditën e Boshnjakëve komuniteti boshnjak në Dragash të marrë 2000 euro? Më mësoni, unë do ta tërheq propozimin. Ku duhet ta paraqes? Vetëm këtë kam dashur — që të kemi obligim që për atë ditë t'i ndajmë dy apo tre mijë euro për komunitetin boshnjak dhe t'ju ftojme në, le të themi, një manifestim festiv. Do t'i afirmojmë të drejtat e komuniteteve joshumicë, nuk kam propozuar asgjë të keqe. Nëse keni një mënyrë tjetër — do ta pranoj.

Bexhet Xheladini: Baldzi, të lutem, mos na qit në pozita të palakmueshme! Se, po del që ne jemi kundër me e fut në Planin e Punës të Kuvendit Ditën e Boshnjakëve edhe Ditën e Goranëve. Nëse

e futish në Plan të Punës të Kuvendit, Ditën e Boshnjakëve, ti duhet me thirrë seancë, se ashtu është Plani i Punës i Kuvendit, me thirrë seancë, me mbajt pikë të rendit të ditës. Nëse është e lejuar një gjë e tillë, është këtu zyrtari ligjor, le të thotë që po, edhe unë po iu them të gjithëve le ta votojnë edhe Ditën e Boshnjakëve, edhe Ditën e Goranëve. Por, nuk e di me Rregullore a lejohet apo jo. Këtu është problemi, jo që jemi ne kundër. Edhe, nëse ka nevojë me nda mjete financiare për këtë ditë, i drejtoheni KPF-së, ose Zyrës së Kryetarit përmes subvencioneve, ne ndajmë mjete për atë ditë, për me e festue. Kur ta futish në Plan të Punës të Kuvendit, duhet me iu përmbajt Planit të Punës, për këto dy ditët me thirrë seancë. A kemi të drejtë ne me thirrë seancë, kur ne i kemi të caktuara deri në 10-12 seanca në vit.

Usmen Baldzi: Ja, e pranoj. Që të mos jetë në planin e punës së Kuvendit — e pranoj. Po e tërheq propozimin, por duhet të jemi të sqartë. Unë në Dragash, tash 25 vjet, marr pjesë në ditën e festës së komunitetit shumicë shqiptar këtu në Kuvend. Këtu në Kuvend dhe jashtë Kuvendit, përveç atyre që nuk marrin pjesë për arsye që i dinë ata vetë — unë jam gjithmonë i rregullt. Këtu i kemi të pranishëm edhe organizatat e luftes, edhe veteranët, edhe të gjithë. Dhe kjo më gëzon, e respektoj dhe e dua. Dhe do të doja që edhe ne, nëse mendoni që përmes Komitetit për Komunitete të kërkojmë buxhet dhe t'i ftojme anëtarët e Kuvendit dhe shoqërisë civile në ditën e festës, atëherë në rregull — e tërheq fjalën dhe do të shkojmë përmes Komitetit për Komunitete. Vetëm që të mos kemi nevojë përsëri ta hapim këtë çështje në Kuvend.

Granit Rifaj: Deshta të ndërlihem me këtë pikë. Në qoftë duhet me qenë në Plan të Punës të Kuvendit, duhet me qenë për të tria komunitetet, atë duhet me e ditë. Në qoftë se nuk duhet – unë të kisha lut edhe ty, koleg, mos me na qit neve këtu në lajthitje për 2 mijë euro të Komitetit ose që keni me bo aso matematika, çdo pikë të rendit të ditës na me i bo politikat e juaja. Është shumë e ulët. Në qoftë se duhet, jeni këtu. Asnjë këtu unë nuk e kam ndie që është kundër ndonjë komuniteti ose kundër ndonjë festës. Seancat solemne – që unë po i kallxoj kryetarit, nëse nuk e di – janë të lejuara për çka të duash. Në qoftë se duam me e mbajt, e mbajmë, në qoftë se duam me e pas si obligative, e shtijmë obligative. Mos na qitni komplet Kuvendin për do politika, për 2 mijë euro, në lajthitje. Ju lutem, bone punën e juaj qysh duhet!

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, pasi u kryen diskutimet, e qesim në votim, Raportin dhe Planin e Punës, pa kërkesën e z.Baldzi, sepse u tërhoq. Kush është për? Kush është kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Raporti vjetor i KKSB-së Janar-Dhjetor 2025. A

dëshiron dikush me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 19 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe ky Raport i KKSB-së. Vazhdojmë me pikën e shtatë: Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. A dëshiron dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Usmen Baldzi: Këshilli Komunal për Sigurinë në Komunitet është një komitet shumë i rëndësishëm dhe një këshill mjaft i rëndësishëm. Në fund të fundit, në të duhet të jenë njerëz eminentë, të cilët kujdesen, njohin ose merren me çështjen e sigurisë së komunitetit në komunën e Dragashit. Dhe është mirë që Kuvendi i Komunës e miraton një këshill të tillë. Përbërja është propozuar nga kryetari dhe emrat e njerëzve që janë aty sipas funksionit — deshëm apo nuk deshëm — duhet t'i pranojmë. Në vendin e parë është Bexhet Xheladini, kryetari i komunës. Në vendin e dytë është policia — ka shkruar rregulloren, atëherë është në rregull. Sait Hoti, gjithashtu. Xhafer Fezjiju është përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame të Dragashit, është në rregull. Munafis Hoxha, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame për rajonin e Gorës, po ashtu në rregull. Anesa Mehmeti është përfaqësuese e komunitetit shqiptar — nuk e di, por meqë është propozuar nga shumica, është në rregull. Muamer Sulejmani është përfaqësues i komunitetit goran — nuk kam të drejtë të ndërhyj në propozimet e komuniteteve të tjera dhe kjo është në rregull. Sa i përket Miralem Rahte — këtu nuk pajtohem aspak. Dhe lus Kuvendin që ky komitet të mos jetë vetëm shpërblim për një shumë të caktuar parash, qoftë 50 apo 200, nuk e di, por që ky komitet të ketë njerëz që e meritojnë, që u përket emri. Njerëz që janë përfaqësues të vërtetë. Miralem Rahte nuk është i tillë. Ai ka qenë në listën e koalicionit Vakati, por koalicioni Vakati është opsion qytetar, nuk është vetëm kombëtar, dhe nuk do të thotë që ai, vetëm pse ka qenë në listën e koalicionit Vakati, sot të SDU-së, është boshnjak. Ai në mediat e Maqedonisë në muajin shkurt ka deklaruar publikisht se është pjesë dhe përfaqëson komunitetin goran, i keni incizimet — e keni dëgjuar të gjithë ju të pranishmit dhe ata që dëgjojnë. Prandaj propozoj një njeri me dinjitet të komunitetit boshnjak të komunës së Dragashit, një njeri që ka qenë shef shumëvjeçar i Zyrës për Komunitete më herët dhe drejtor në administratën e vjetër të vetëqeverisjes lokale në Dragash; një njeri apolitik dhe tani në pension, ende me shëndet të mirë, merret me shkrime, me kulturën boshnjake dhe me komunitetin. Ai quhet Mehmet Hamza. Lindita Piraj është përfaqësuese për barazi gjinore, në rregull. Zeni Krasniqi është drejtor sipas funksionit, në rregull. Reshat Ajdini është nga këshilli i prindërve, gjithashtu në rregull. Uzair Hamza është përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete, në rregull. Behar Brenoli, ky KLSB, e di që ka ekzistuar më

herët; nëse nuk ka tjetër, dhe meqë ai është drejtor — shëndetësi — nuk duhet t'i dyfishojmë funksionet. Të mos ndjekim dy paga, mos e bëni këtë, njerëz, sepse ne këtu e përfaqësojmë popullin. Një pagë është e mjaftueshme. Ja, më gëzon që unë jam anëtar i kuvendit — gjimnazi, nuk ka më — një vend pune. Le të dijë ky popull një herë të vetme të vërtetën për ne. E jo dikush të ketë tetë paga, dikush shtatë, pesë, e dikush një ose asnjë. Dhe në fund, Suad “Rilindja”. Asnjëherë nuk kam dëgjuar, as nuk e kam parë. Nuk e dimë çfarë është Rilindja, ad-hoc, a është aktive. Zoti Suad është shoku im, ish-bashkëpunëtor partiak e tjetër, por mendoj se propozimi për të është i pabazë sepse ai punon në komunën e Dragashit, ai është në shërbimin civil, dhe nuk ka të drejtë — kudo shërbimi civil ka kufizime të caktuara, të mos hyjmë tani në ligj. Në vend të Rilindjes, të mos themi që është edhe imam, edhe përkthyes, edhe përkthyes privat, edhe udhëheqës privat i udhëtimeve apo guidë turistike nëpër Kosovë. Mjaft më pesë-gjashtë funksione. Kemi Nuhin Tairovci, i cili ka qenë deri dje me ju, njeri që ka qenë anëtar i bordit të drejtorëve, i propozuar nga kryetari, që ka qenë me të gjithë ju — edhe me pozitën edhe me opozitën — njeri pa punë. Ka një organizatë joqeveritare të njohur në gjithë Kosovën, *Merhamet*, ka punuar, ka organizuar edhe Ditët e Boshnjakëve. Prandaj nuk dua që të gjithë këtë ta merrni si presion, por si propozim të sqartë dhe të bazuar. Veçanërisht i lus përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, boshnjake dhe gorane, ta mbështesin dhe ta pranojnë këtë propozim timin.

Artan Loshaj: Pasi po diskutojmë për vendimin e themelimit të KKSB-së, edhe dje në Komitet me kryetarin e kemi diskutue – sipas nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MPB-së, si dhe Nenit 32 të Statutit, nenit 03 12 të MAPL-së, këtë Këshill e përfaqëson kryetari i Komunës – shumë mirë – nën dy është Shaqir Uka, komandant i Stacionit Policor; nën tre është Sahit Hoti, komandant i Stacionit Policor në kufi, këtu me rregullore dhe me ligj nuk thuhet, po masi jemi në kufi, është mirë, kryetar, edhe dje kam thënë, më vjen mirë që është komandanti; numër katër është Xhafer Fejziu, përfaqësues i Bashkësisë Islame të komunitetit shqiptar, mirë është shumë; numër pesë është Munafis Hodza; Anesa Mehmeti nga shqiptarët; Muhamer Sulejmani nga komuniteti goran; Miralem Rahte – e kam koleg – bolla Baldzi foli, nuk e meriton, e juaja është se i keni votat; me numër nëntë është kryesuesi i Komitetit për Komunitete – dje keni pas takim, a ka mundësi me e ditë prej juve, kush është kryesuesi? Në qoftë se është kryesuesi, duhet me e dhënë emrin ju edhe me e ditë na kush është ai. Nuk kam të keqe kurgjo me kolegët e mi, në qoftë se vjen kolegja e nderume, që ligji na thotë se zyrtarët publikë të mos kenë dy paga – jemi nja tre a katër këtu – s'po due me emra, se me disa s'kam raporte private kështu – në qoftë se ligji thotë që dy vende të punës

– unë njërin e kam ngrirë, kryetar, e dijs shumë mirë, me vendimin tënd – s’po e di këta kolegët tjerë a e kanë bërë a jo? Se nuk mundesh ti me e shkelë ligjin, të punosh edhe në shëndetësi ose në arsim, të punosh edhe në Kuvend. Në qoftë se këtë punojnë pa pare, me vullnet, kam qef edhe unë me dhënë kontribut pa pagesë, për arsye se prej qasaj QKMF-së kam ardhë unë sot kuvendar prej qytetarëve. Due me e dijtë, në qoftë se është prej komunitetit joshumicë, për shembull Ventazes, a i takon me qenë edhe në QKMF, me qenë edhe në Komitet, me qenë edhe në seancë, me qenë edhe kryesuese. Numër dhjetë është Lindita Piraj, sipas ligjit, është shumë mirë; Zeni Krasniqi, drejtori; Reshat Ajdini i Këshillit të Prindërve; përfaqësuesi i FSK-së, një emër nuk na keni thënë, a ka mundësi një sqarim, ta dimë kush është emri i përfaqësuesit të FSK-së; me numër katërbëdhjetë, superdrejtori i juaj, i ledhatuari, z.Behar Brenoli, e paska një KLSP – ta kam thënë edhe dje, kryetar, për arsye se dy a tri komunitete jetojnë në Komunën e Dragashit, më ke thënë që nuk ka anëtar nga komuniteti shqiptar. E kam lënë, po thuesh nuk ka. Behari nuk e meriton, absolut hiç. Se këtu po ju mungon veç Duda Balje, ju kam thënë dje, edhe po ju mungojnë votuesit e CDU-së, se krejt anëtarët e CDU-së i keni shti në listë. Me numër pesëmbëdhjetë është drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, prapë hala nuk jemi duke e ditë kush është. Në qoftë se ka mundësi me na shpjegue kush është këtu. Numër gjashtëmbëdhjetë – këtë mo mos ta diskutojmë – se ky është supermeni, i famshmi, Uzair Hamza, por sipas pozitës, prej zyrës komunale, i takon me qenë. Me numër shtatëmbëdhjetë është kolega i Kuvendit – nuk jam kundër Suadit – por prapë po ju them, pasi jemi dy-tri komunitete, ti po thuesh me ligj nuk kemi të drejtë, po a ka mundësi një OJQ të komunitetit shqiptar të jetë në listë, në vend të 1.11, këtu kryetar, nuk e ke përmbush këtë – sipas ligjit, 1.11 thotë kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi. Këtë po thuesh komuniteti shqiptar nuk e ka. A ka mundësi, në vend të kësaj, nuk bëjmë shkelje, ta shtijmë një OJQ të komunitetit shqiptar. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Unë dje, në cilësinë e anëtarit më të vjetër të Komitetit për Komunitete, kemi mbajtur mbledhje në të cilën kanë qenë të pranishëm katër anëtarë: Xheladini, Ventaza, unë dhe zonja nga PDK. Meqë ishim numër çift, nuk kemi pasur shumicë të nevojshme. Ne duhet të zgjedhim kryetarin e Komitetit për Komunitete, dhe këtë do ta bëjmë në periudhën e ardhshme. Dhe ai që do të zgjidhet në komitet, ai do të jetë anëtar — vetëm sa për ta sqaruar.

Bexhet Xheladini: Atëherë, në bazë të nenit 12 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), neni 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL, neni 32 i Statutit të Komunës së Dragashit, unë si kryetar i Komunës e

kam nxjerrë këtë Propozimvendim me emrat e anëtarëve të KKSB-së. E pashë se disa parafolës kishin disa rezerva lidhur me këtë. Sa i përket numrit tetë, Miralem Rahte, ky është propozim i komunitetit boshnjak dhe ky emër mund të ndërrohet me propozimin tuaj, votohet dhe munden me u ndërrue. Përndryshe, ky është Propozimvendim dhe, në bazë të vendimit që e merr Kuvendi, do të mbetet Miralem Rahte apo dikush tjetër. Sa i përket kryesuesit të Komitetit për Komunitete, ky Komitet, në seancën e radhës ka me e mbajt një takim edhe ka me e zgjedhë kryesuesin. Kështu që, automatikisht, ai kryesues i cili zgjidhet, del automatikisht emri i tij dhe është anëtar i KKSB-së. Lindita Piraj, po ashtu, nuk ndërrohet, Zeni Krasniqi nuk ndërrohet, Reshat Ajdini nuk ndërrohet. Për përfaqësuesin e FSK-së, ata na bien emrin dhe atë emër që na bien FSK-ja, ai do të kooptohet si anëtar i KKSB-së. Edhe, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, unë e kam emëruar drejtoreshën, kështu që emri i saj do të futet këtu. Behar Brenoli është përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Komunitet. Ky këshill është i vetmi i themeluar në Komunën e Dragashit, vetë, në Krushevë, Në pjesën e Opojës nuk ka, pasi nuk ka, ne s’kemi pas emër, kështu që, nëse gjatë mandatit themelohet, ne mundemi një emër të tillë me e qit si anëtar të KKSB-së. Uzair Hamza po ashtu është emër që nuk ndërrohet. Edhe Suad Tosuni është një përfaqësues i OJQ-së, edhe ky është emër i cili mund të ndërrohet me propozimin tuaj. Por, nuk mund të bëjmë dy OJQ, edhe një nga shqiptarët, sepse rregullorja e parasheh vetëm një OJQ. Kështu që, propozimet që kanë dalë këtu, munden me i qit kryesuesi në votim, edhe cili propozim fiton, ngelet anëtar. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, nuk të thashë me e largue Suadin, se edhe dje të kam thënë nuk jam kundër Suadit. Por, ke mundësi, kur ke pas mundësi me e shti të nderumin në kllapa, qite në rend ditë, qite tetëmbëdhjetëshin z.Eminin. Për z. Eminin s’po na kthehet rregullorja me e shti në kllapa, shtije numër tetëmbëdhjetë, po e ke qit knena, e ke qit ‘anëtarët e këtij Këshilli (përfshirë edhe koordinatorin)’. Mos e përfshij, përfshije në listë, ta votojmë na. Edhe, ki lluft, me pas vullnet – se unë e di, pak të vjen siklet, opozita me të dhënë propozim, po duhet me qenë i gatshëm me e pranue. Në pikën 1.11, kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, nuk e kie, kryetar. Këtu me rregullore, me ligj po ta lyp. Nuk jam kundër unë, qe unë kam me e votue Suadin, e kam shok, e kam mik të shpisë. Po problemi është 1.11, kryesues i Ekipit Veprues. Shtije një OJQ të komunitetit shqiptar, ose një të invalidëve, ose dikë, edhe shtije në listë me numër 18, shtije koordinatorin Adem Emiri, mos e shti në kllapa, mos e fshih nën sqetull, qitne në publik!

Resul Fetahu: Një OJQ nuk e propozove, Artan!

Artan Loshaj: Një OJQ, për shembull, Radio Sharrin, edhe është media lokale, edhe informohet qytetari më mirë, ma thjeshtë, informohet çka po ndodh me sigurinë nëpër fshatra, nëpër lagje, nëpër polici, nëpër shëndetësi. Qe, për shembull, Radio Sharrin e propozoj.

Granit Rifaj: Sa për sqarim qetu, se unë shumë nuk e kuptova. Këtu e kemi, te numri 14, Behar Brenolin, që tha në komunitetin shqiptar nuk ka këso edhe s'un ia lëmë ne fajin Behar Brenolit ose kryetarit, aty jam okej. Por tash, ku foli kolegu, në qoftë se shkojmë te OJQ-të, një prej Këshillit të Veprimit Lokal po u shtojka nga komuniteti pakicë, tash edhe OJQ-ja nga komuniteti pakicë, besoj që ke shumë OJQ edhe ke bashkëpunue shumë, ke nda fonde për ato OJQ edhe në komunitetin shumicë, edhe kish qenë më e rrugës – duke mos pas kurgjo kundër këtij zotërisë këtu – ama duhet me u përfaqësue edhe shqiptarët pak më shumë. Po nëse ia keni mësy më këso pozita me e nda pushtetin për me marr pushtet absolut, ia pafshit hajrin!

Bexhet Xheladini: Sa i përket OJQ-së, me rregullore nuk kemi të drejtë me i propozue dy, kemi të drejtë një. Keni të drejtë ju si Asamble me e ndërrue. Nëse i qesim dy OJQ, një shqiptare, një të komunitetit joshumicë, na kthehet jo e ligjshme, sigurt. Rregullorja e parasheh koordinatorin, duhet dikush me e përgatit dokumentacionin. Ademi është zyrtar ligjor. Mirë, po kush ka qenë para se me qenë unë kryetar? A ke qenë Adem ti, a ke qenë prej fillimit? Edhe një herë po them, sa i përket OJQ-së, rregullorja e parasheh një OJQ. Nëse doni me e ndërrue, urdhëroni, qitne në votim, nëse nuk doni, line këtë! Aty ku mungon kryetari, mbledhjet i udhëheq nënkryetari. Ajo nënkuptohet, është Neni 3. Kryesues është kryetari, në mungesë të tij është nënkryetari, kështu që nuk ka nevojë me e qit. Është, faktikisht është.

Granit Rifaj: Kur folëm për atë se dy OJQ nuk mundim, korkush nuk propozoi dy OJQ. Thashë, në qoftë se komuniteti pakicë janë... numër 18, Behari, i vetmi këshill, atëherë OJQ-ja le t'i takojë komunitetit shumicë. Kaq! Një propozim e dhanë, Radio Sharrin, mundemi të dytin me ia bo qefin Uranit, me ia dhënë një propozim Tv Opojën, ose e keni OJQ "Avoko". Çfarëdo OJQ-je, por le t'i takojë komunitetit shumicë, se si shumë iu kemi dhënë, e masnej po përlahen. Faleminderit!

Resul Fetahu: Faleminderit! A ka edhe dikush tjetër me e marrë fjalën, ndonjë propozim? Nëse nuk ka, atëherë i qesim në votim. Propozimi i z.Baldzi, që në vend të Miralem Rahtes të jetë Mehmet Hamza, dhe në vend të Suad Tosunit të jetë Nuhija Tairovci. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 8 vota për, 11 kundër dhe zero abstenim, nuk kalon propozimi i z.Baldzi. Atëherë, a keni dikush ndonjë propozim konkret për OJQ shqiptare?

Granit Rifaj: I nderum koleg, a po më ngojsh tash për me ta sqarue veç pak. Propozimi i Baldzit nuk kaloi, pat propozim tjetër, që thamë – edhe le ta ndije mirë populli, masi po dësh edhe një herë ma ta sqarue, mos të kalohet në heshtje – komuniteti shumicë mos me mbet i papërfaqësuar, OJQ-ja më qenë e komunitetit shumicë, që i bjer e shqiptarëve këtu. Se, komunitetet pakicë e kishin, thashë, edhe Beharin prej një këshilli lokal a çka është, edhe me i mbet komunitetit shumicë. A je me i mbet komunitetit shumicë OJQ-ja, a komunitetit pakicë? Kaq, e thjeshtë është. Cilin të duash prej komunitetit shumicë propozoj, unë ta mbështeti. Veç si propozim e patëm këtë. Faleminderit!

Resul Fetahu: A ka dikush ndonjë propozim konkret? Atëherë e qesim në votim propozimin për ndryshimin e OJQ-së? Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 9 vota për, 11 kundër dhe zero abstenim, nuk kalon as ky propozim. Atëherë e qesim në votim Propozimvendimin e kryetarit për themelimin e KKSBS-së, pa ndryshime. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 11 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë kalojmë te pika e anulimit të Vendimit për miratimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë?

Bexhet Xheladini: Atëherë, unë në KPF e kam sqarue. KPF-ja i ka rekomandue Asamblesë që ta fusë këtë pikë të rendit të ditës. Materialin nuk ua kemi dërgue juve, sepse, pasi e kemi dërgue materialin e Asamblesë, ky vendim ka ardhë jo i ligjshëm. Andaj, unë propozoj që Kuvendi ta votojë këtë pikë të rendit të ditës dhe ta anulojë këtë vendim. Në seancën e radhës, ne do të përgatitim një material, me dokumentacion komplet, ashtu siç ka kërkuar edhe MAPL-ja. Ajo do të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës, do ta miratojmë dhe do ta çojmë për miratim në MAPL. Siç e dini, si çdo vit deri më tash, këto prona dhe kjo listë është dërguar e njëjtë, e pandryshuar, mirëpo kësaj radhe shumë komunave, për të mos thënë të gjithave, i është anuluar ky vendim. Ministria kërkon strikt që të zbatohet Ligji për Këmbimin e Pronave apo Dhënien në Shfrytëzim të Pronave. Unë kam bisedue me drejtorin Qamil Kolloni, ai është duke e përgatit këtë material, edhe në seancën e radhës do ta kemi në pikë të rendit të ditës. Kështu që, unë u propozoj anëtarëve të Kuvendit që ta anulojnë këtë vendim të cilin e ka prurë Asambleja vitin e kaluar. Është e vërtetë që kam premtuar se do t'jua dërgojmë Vendimin e Ministrisë. Atëherë, mundemi me e bo një pauzë të shkurtë, derisa Shërbimi i Kuvendit ta përgatitë materialin.

Resul Fetahu: Atëherë, shkojmë në pauzë! Një orë pauza zgjat!

Atëherë, vazhdojmë me seancën. Besoj që materialin e keni marrë të gjithë. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për anulimin e këtij Vendimi? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, zero kundër dhe 1 abstenim, miratohet edhe anulimi i këtij Vendimi. Kalojme te propozimi i dytë, i z.Usmen Baldzit, që të miratohet Komisioni Ad hoc, prej të gjitha partive, për energjinë elektrike. A do dikush me e marrë fjalën?

Shukri Myrtezani: Faleminderit! Meqenëse është hera e parë që unë po e marr fjalën në këtë legjislaturë, i kisha uruar të gjithë kolegët asamblesitë për punë të mbarë, veçanërisht kolegët e rinj që sot e dhanë betimin! Kryesuesit i uroj punë të mbarë! Ju bëj një thirrje kolegiale që të gjithë të bashkohemi në vizion të mirë për vendin, sadopak t'i dalim në ndihmë edhe t'i përkrahim projektet të cilat i ndihmojnë vendit tonë. Edhe ashtu, ne jemi zonë e thellë, besoj që me një bashkëpunim ndërkolegial sadopak t'i ndihmojmë zonës edhe vendit tonë, ta çojmë përpara. Unë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e mbështes propozimin e z.Baldzi që të formohet një komision, por pa prezencën e kryetarit. Unë propozoj që z.Resul të jetë udhëheqës i këtij komisioni, edhe partitë tjera të përfaqësohen me nga një anëtar të vetin. Faleminderit!

Zgjim Fejza: Nga radhët e PDK-së e propozojmë Granit Rifajn!

Uran Halimi: Nga Grupi ynë parlamentar propozojmë znj.Afrore Vejseli!

Ventaza Esati: Nga JGP për anëtar të Komisionit për energji propozojmë z.Danis Hodza!

Dzumida Maznikar: Nga SDU propozoj veten: Dzumida Maznikar!

Usmen Baldzi: Nga Koalicioni VAKAT, Usmen Baldzi!

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, propozimet që erdhën nga partitë politke janë: Resul Fetahu, Granit Rifaj, Afrore Vejseli, Danis Hodza, Dzumida Maznikar, dhe Usmen Baldzi. Ky është Komisioni që do të merret për energji elektrike. Atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 20 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet kjo kërkesë për formimin e këtij Komisioni. Themelohet Komisioni! Vazhdojmë me propozimin e Uran Halimit për formimin e Komisionit për mirëmbajtjen e veturave. A do dikush me e marrë fjalën?

Vezir Reshiti: Atëherë, kolegë delegatë, ne si parti LDK, nuk kemi anëtar për propozim.

Granit Rifaj: Në emër të GP të PDK-së propozojmë z.Zgjim Fejza.

Uran Halimi: Nga LVV do të jem unë kandidati për anëtar të komisionit.

Danis Hodza: Nga JGP nuk kemi propozim për anëtar të komisionit.

Dzumida Maznikar: Nga SDU nuk kemi propozim për anëtar të komisionit.

Usmen Baldzi: Një pyetje për pozitën. Duhet të bashkëpunojmë, mos e bëni kështu.

Granit Rifaj: Mu po më vjen keq prej pushtetit që nuk po e merrni përgjegjësinë tuaj. Ky komision u votua. Është mirë në të ardhmen mos me ia lënë veç opozitës me bo çka të dojmë, me qenë aty edhe me qit realitetin, se për atë punë po bëhet komisioni. Po në qoftë se jo, atëherë le të plotësohet prej partive tjera, masi nuk kanë këta kandidat. Nuk do me thënë që me u bo me tre anëtarë.

Resul Fetahu: Mundeni me e propozue edhe prej partive tjera.

Artan Loshaj: Kryesues, unë në fillim kërkova që me e pa sa veta jemi, sa anëtarë do të ketë komisioni. Tash kjo u bë një rrëmujë këtu. Se ë fillim mirë, e votuam për rend ditë. Tash po e shoh që s'po doni, se tash i keni bo votat, kur të del në votim prapë nuk ka me u formue. Tash na sa të duam mundemi me propozue, ju i keni votat e s'ka me kalue. Ose në fillim nuk e qitshit hiç. Nuk jam duke u interesue unë, se këto sende kanë shkue, a i zbulojmë a jo, unë personalisht nuk jam shumë i interesuar me i ditë këto sende. Ama tash, kur të dalim në votim, na edhe ka një, edhe ka dy, edhe ka tre po i propozojmë, që po e propozoj veten unë, për shembull. Po kur duhet me marrë vota, kjo nuk ka me kalue. Kjo është veç një lojë që para qytetarëve po dalim keq. Jo për diçka, se nuk jam i interesuar absolut për këto sende me i përcjellë, se këto kanë kalue.

Vezir Reshiti: Po kjo nuk ishte kërkesë e jona, edhe mos po i përzina prokurorit atje, kanë fillue mirë hetimet, pale a po kemi kompetenca na për këtë. Këtu mos t'i hyjmë, ishalla del edhe këtu lart, pale a kemi të drejtë me iu përzie prokurorit. Janë organet ku duhet me u drejtue për këto sende, qysh janë drejtue ma herët, le të fillojnë prapë le të drejtohen.

Granit Rifaj: Veç për me e sqarue, se edhe më herët e thashë, u dashtë me e kuptue pak. Kjo praktikë e komisioneve hetimore ka ardhë në Kuvend të Dragashit prej pushtetit të juaj, jo prej nesh. Edhe në qoftë se ka bo një herë, dy herë, nuk jemi përzie prokurorit, nuk i përzina edhe sot. Na këtu e bëjmë një raport edhe e çojmë në organe ma tutje, nuk bëjmë pale çka. Kështu që, nëse nuk doni ju, atëherë le të bëhet me të tjerë, po është më mirë me qenë të gjitha partitë aty. U marrë një vendim këtu që me u bo një komision, është më mirë me e dhënë një propozim, nëse nuk do me dhënë propozim, e japin tjerit. Kalon, se kjo ka kalue në rend të ditës, nuk duhet me kalue këtu. Këtu veç emrat kalojnë. Faleminderit!

Pajtesa Berisha: Sa i përket komisioneve herën e parë që janë votue, komisionet hetimore, nuk ka ardhë kërkesa prej ndonjë asambleisti, ka ardhë kërkesa prej Ombudspersonit. Prej Zyrës së Kryetarit ka shkue edhe ka kërkue hetim. Për atë arsye u ka krijue komisioni. Por nëse ka të drejtë,

në rregull, le të bëhet kërkesa prapë, le ta çojë në Zyrë të Kryetarit, le ta bjer kryetari, krejt në rregull është. A e dish çka do me thënë me t'çue kërkesë Ombudspersoni? Shumë mirë, edhe tash nëse i keni votat ju përkrahim, krejt në rregull është.

Uran Halimi: Nëse më lejohet dy fjalë, para propozimit. Tash, unë realisht mendova për duartrokitje, profesori kur e mori fjalën edhe na kërkoi bashkëpunim. Mandej kryetari është transparent, i merr ato shpërblimet prej qeverisjes për transparencë dhe për qeverisje të mirë. Këtu realiteti është që transparencën po dojnë me e zhduk. Ku është bashkëpunimi, profesor? Pse me u frikësue, ta shohim bashkë. Unë ju thashë, nuk është patjetër që unë kam të drejtë. Është një aludim i jemi, e formojmë komisionin, nuk u gjet kurgjo, duhet me qenë edhe ju anëtarë aty, me e pa që s'u gjet kurgjo në të. Kështu që, pse po hezitoni unë nuk po e kuptoj, çka po doni me fsheh me këtë? Komisioni është formuar, ju veç emrat keni me i votue tash. Është mirë me qenë edhe ju, e dini çka ka ndodhë me atë komision, se nesër ankoheni. Sa i përket prokurorisë, na prokurorin këtu s'e bëjmë. Ne e bëjmë një raport, çka u gjet, e çka s'u gjet. Prapë prokurori e bën punën e vet. Në kërkond as nuk mundim me dënue, as nuk mundim me e akuzue padrejtësisht. Ju ftoj për bashkëpunim. Edhe unë po pajtohem me ty, profesor, po të ftoj edhe unë ty tash me bashkëpunue në të mirën e qytetarëve. Jemi duke e hulumtue paranë publike, paranë e qytetarëve që a kanë votue edhe vazhdimisht paguajnë tatim për na me funksionue këtu në mënyrën e drejtë dhe të duhur. Emri i dytë prej LVV-së është znj. Afrore Vejseli. Faleminderit!

Shukri Myrtezani: Uran, sa për bashkëpunim për projekte të mira, kurdoherë më ke përmbra. Por, sa me u përzie në përgjegjësi edhe në detyra të tjetërkujt, kurrë nuk më ke mbrapa. Ajo është përgjegjësi dhe detyrë e dikujt tjetër, i ke organet kompetente ku mundesh me u drejtue. Aty është i shpallur tenderi, në qoftë se ka shkelje, unë po besoj që ka organe të cilat i shqyrtojnë ato ma mirë se na. Edhe të ftoj ty që ta marrësh atë dosje, edhe ta çojsh drejt ku është vendi. Nuk mundeni me e lujt na rolin, nuk jemi na ekspertë që mundemi me i trajtue ato gjëra. Ato gjëra i trajtojnë ekspertët. Në qoftë se është shpallë tender publik, edhe në tender publik nuk ka pas shkelje, nuk ka pas ankesa, nuk e di çka lypim na me e vlerësue aty. Kështu që, janë organet kompetente, merri dokumentet, çdo gjë e ke publike, edhe shko. E sa i përket, për bashkëpunim, sinqerisht po të them, për vendin tonë, ta dish që më ke mbrapa. Unë këtë besoj që e kam dëshmuar qe 20 vjet punë, ku në vend të punës atje, secili bashkëqytetar i joni që ka ardhë e ka kërkue ndihmë, kam qenë në rend të parë që i kam dhënë ndihmë. Edhe, kurrë nuk e kam kqyr as përkrahjen politike, as familjen, e as kërkond. E kam dhënë maksimumin që u dashtë me e dhënë. Mundesh me e pyet çdokënd, por

prapë unë jam qaj që jam. Në qoftë se është diçka që duhet me i dalë në ndihmë me të vërtetë edhe nuk prekim në kompetenca ose në ligj, më ke mbrapa. Faleminderit!

Uran Halimi: Unë nuk po mendoj që ne jemi duke bërë tejkalim të kompetencave. Nëse po, e kemi zyrtarin ligjor, ka mund me na thënë që ne nuk kemi të drejtë me e formue një komision të këtij lloji. Nuk është tejkalim i kompetencave, i nderum. Sa i përket ndihmës, bashkëpunimit në punë të mirë, punë e mirë është edhe me e ndalë hajninë, i nderumi profesor. Unë po ta kërkoj bashkëpunimin me e ndalë të keqen. Kur e ndalish të keqen, vjen puna e mirë. Nuk po të kërkoj bashkëpunim për më hy në kompetenca të dikujt tjetër. Unë nuk kam qef me hy në kompetenca të kërkujt. Na po e bëjmë atë që neve na takon, është kompetencë e jona, e Kuvendit. Atë raportin, kur na ta dërgojmë në prokurori, prokurori munden me e gjujt, munden çkado me bo. Thjesht, na e kemi deri të përfundimi i raportit, është kompetencë e jona, jo e prokurorit. Kur të vjen te kompetenca e prokurorit, ai munden me na akuzue neve, me thënë nuk keni të drejtë ju me e bo këtë. Nuk merret parasysh, kurgjo kërkujt. Thjesht, qekjo është puna më e mirë e mundshme, profesor, e mandej vijnë ato tjerat, të mirat. Kur ndalet e keqja është ma mirë sesa me luftue për të mirën. Evitimi i të këqijave automatikisht e sjell të mirën. Qekjo është ajo e mira që unë po ua kërkoj juve, bashkëpunimin e mirë, në punë të mira që ti e kërkove, është qeky bashkëpunimi për punë të mira. Faleminderit shumë!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, ju përshëndes të gjithëve! Kisha pas dëshirë që të jemi të sinqertë e të drejtë, e të mos bëhemi – ndoshta s'është fjalë adekuate për momentin – po dyftytyrësia nuk bën me u bo. Dyftytyrësia nuk është e mirë, duhet me mbajt qëndrime parimore, me e mbajt vetveten, pa marrë paraqysh çfarë roli jemi, dyftytyrësinë nuk bën me bo. Emrin nuk po ia përmendi se del në replikë, e di për kënd është fjala, ish-kryesuesin. E kemi formue një Komision na, për hetim, dhe ka qenë kryetar i Komisionit. Dhe në gjysmë të punës – disa herë kam kërkue në Asamble të kalume – me e vazhdue punën, asnjëherë nuk na thirre mo. Pse? Mos po doni me formue komisione veç sa për sy e faqe, me ndie opinionin, me bo propaganda. E di ai për kënd është fjala, emrin nuk ia përmendi se del e fol. E ka replikë me tjetërkënd, me mu nuk e ka, se nuk ia jap mundësinë. Dua me qenë shumë i sinqertë, dije mirë edhe dijeni mirë, ma hetim që kemi qef unë edhe vëllai im me bo, ju nuk keni asnjëri këtu. Asnjëri nuk keni qef, dijeni mirë! Na këtu jemi për me e mbrojt paranë publike, edhe neve na kanë besue njerëzit edhe kanë me na besue, se e dijnë shumë mirë që asnjëherë në jetë nuk kemi vjedhë, nuk e keqpërdorim paranë

publike. Por, ai komision, që po thoni nuk po doni me marrë pjesë, na po ua lëmë mundësinë juve, ua votuam komisionin në mënyrë të pavarur, edhe me e formue komisionin, ua dhamë të drejtën, i keni kandidatët, një a sy, a tre, a s'keni mundësi me gjet hiç, punë e juaja është ajo. Ju keni kërkuar, e keni mat, delni në ballë, punoni, kryeni punën. Na bini raportin! Ju faleminderit shumë!

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Dallimi në mes komisionit i cili është formue, ka qenë adresa shumë e saktë, se qytetari i është drejtue Kuvendit për kërkesën e cila nuk ka ardhë në Kuvend. Dhe ajo është e ligjshme, për arsye se Kuvendi duhet t'i kthejë përgjigje. Dallimi i asaj kërkesë dhe dallimi në mes kërkesës së sotme për krijimin e një komisioni për hetimin e një tenderi në prokurim që është hap, është Organi Shqyrtues i Prokurimit, organi më i lartë, ku të gjitha bizneset private kanë të drejtë ligjërisht të bëjnë ankesa. Dhe, në bazë të shqyrtimit të OShP-së, komisioni është i detyruar të bëjë rivlerësimin. Tash, ju si Kuvend po doni t'i merrni kompetencat krejtësisht të dikujt tjetër. Çka është më interesant, po bëni edhe vlerësim, edhe po e vlerësoni, me hajni, e pa hajni, kur ende tenderi nuk ka fillue të ekzekutohet. Këtu është dallimi, dhe ju po merrni detyrën edhe adresën e dikujt tjetër. Këtu është krejt gabimi. Në qoftë se dikush ka kaq dëshirë – qe katër vjet duke e përmend prokurorin, edhe sot prokurorin – merre or ti shoq një krevat, shko rri te prokuroria edhe çdo lëndë çoje në prokurori. Po çoje një herë biznesin tënd të motorrave që je duke punue qe sa vjet pa regjistruar, kur je qe për me e mbrojt parandë publike. Nuk është shumë e ulët, dëgjo ti e pastaj dalish. Qe katër vjet na jemi duke e dëgjue këtë. Jo personale, po e përdori fjalën 'hajni' këtu. Me çfarë të drejte? Nuk mund të dënohet veprimi demokratik. Nuk janë të interesuar dhe nuk shohin arsye delegatët që të krijojnë komision për këtë lëndë. Ju e paraqitët, priteni votimin edhe u krye muhabeti. Qekjo është demokracia. Nuk mundeni ju që t'i dhunoni subjektet politike, se ata nuk janë duke parë diçka të paligjshme. Prandaj, ju si opozitë, në qoftë se e shihni, i keni organet, rrugët tjera, urdhëroni veproni!

Uran Halimi: Tash, mungesa e argumenteve kalon në personale. Drejtor, unë punoj privat çkadoqoftë, hiç nuk e kam problem atë. Punoj unë me fytyrë edhe me djersë të ballit, këtë e kam dëshmue vazhdimisht. Nuk i tutem asjë pjese ligjore, asnjë rrugë ligjore, asnjë komisioni. Qe, ti mundesh me ma formue kur të duash, unë jam i hapur për krejt sendet. Unë nuk e di çka është kjo frikë, pse po tuteni qekaq? Ku është transparenca? Samidini e votoi komisionin, tash del më kallxon mu çka kemi bo me një komision paraprak. U formue komisioni, s'kemi emra, s'e diskutoni. Vazhdojmë me emra tjerë. Edhe, sa i përket aspektit personal, drejtor, nëse ke ndonjë punë, e kryjmë. Veç më kontakto! Privatish kur të jem, hiç nuk e kam problem atë pjesë. Ama,

këtu jemi për të mirën e qytetarëve, këtu nuk jemi për interesa personale. Absolutisht, kush e ka për obligim atë punë, le ta kryejë. Ama, mos në personale, drejtor, se hiç nuk të ka hije. E hiç ma pak, kur je i emëruar politik. Ti nuk ke të drejtë edhe fjalën me e marrë këtu, shumë mirë tha Graniti, po thuaj faleminderit kryesuesit që ta dha fjalën.

Granit Rifaj: Veç për sqarim, po due krejta me i prek nga pak, se këtu po politizohet prej pushtetit, e jo prej nesh. A ka pas të drejtë Urani apo jo këtu, unë po të tregoj, unë nuk kam dyshime personale, edhe në qoftë se ka hajni janë edhe prokuroria – por në qoftë se po duhet me u bo një komision hetimor, që ka qenë praktikë e juaja, po mos të hyjmë në personale, se kjo nuk është luftë e jemja personale. Një tender, në qfotë se u bo – na kemi me i marrë dokumentat si komision – në qoftë se u bo në mënyrë të rregullt edhe në mënyrë të ligjshme – na nuk mundim me konstatue diçka tjetër. E dyta, te kërkesa që foli drejtori, që hiç nuk ka pas të drejtë me folë për këtë pikë, tha se herën e parë u bo prej Ombudspersonit, shumë e qartë ka qenë prej kryesuesit të kaluar e sqarume pse nuk ka hy në rend të ditës, me dokumente e me krejta. Qaj që ka qenë komision hetimor, mundemi me i qit dokumentet, ajo pikë nuk ka hy në rend të ditës se ka pas Vendim të Kuvendit Komunal të Dragashit me u bllokue pikat për hidrocentrale. Pikë është këtu, nuk ka çka. Qeky Kuvend ka marrë vendim, qeky Kuvend munden me e shti pikë të rendit të ditës nesër. Ama, e keni bo. Unë nuk po them që ti e ke bo për diçka personale me dikënd. E ke bo, ta ka marrë mendja që sqarohet diçka. Edhe këtu, e njëjta është, veç kanë me u sqarue. Bile, në qoftë se nuk ka këtu keqpërdorime, ka me i ra marrja Uranit që ka qenë iniciues i kësaj pune. Nuk jam duke dashtë me e mbrojt, as Uranin, e as atë, ishalla nuk ka keqpërdorime edhe ishalla vazhdon kështu, fort mirë. Ama, kur të hyjmë në këto anët personale, a i ka pagua ai do porez, ti mundesh me e dënue, jo me dalë në foltore. E treta herë është që personale je duke i qit. Në qoftë se ka diçka Urani personale, bonja personale. Këtu e kemi shumë thjesht, në qoftë se ke anëtar të komisionit, mirë, nuk ke, i propozojmë këta. Ju e keni vendos me vota, se ma herët s'un e bëtë, se nuk e keni ditë matematikën mirë, tash i bëtë votat. Po një komision që u votue, ti veç emrat mundesh me i rrëzue. Vazhdo tënden, në qoftë se nuk ke propozim, thuj s'kam propozim, po të lutem, mos ta qesim në personale. Tash ti për atë, unë për atë, ky për këtë, nuk po e shoh të udhës që kemi me zgjidhë diçka. Në qoftë se jam unë gabim, më thuj që jam gabim, veç e ke gabim.

Vezi Reshiti: Unë s'un po e pranoj gjithë këtë presion. Komisionin po thoni me e formue, ne s'kemi dyshime që janë bo keqpërdorime. Me pas dyshime që janë bo, e kishna formue. Edhe një diçka kur s'do dikush me e formue, pse gjithë ai presion iu bëhet njerëzve. Janë organet ku duhet

me u drejtue edhe kurgjo kërkujt. A e domosdoshme është me mendue edhe unë sikur ju, po thoni ju me e bo, edhe unë me mendue sikur ju, me e bo, a? Na s'mundemi me mendue krejt njësoj.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, emrat e propozuar janë: Zgjim Fejza, Artan Loshaj, Uran Halimi, Afrore Vejseli dhe Usmen Baldzi. Pesë anëtarë për komision. Atëherë, e qesim në votim formimin e komisionit.

Artan Loshaj: Kryesues, ndoshta më ke keqkuptue. Thashë, në qoftë se duhet, e propozoj. Nuk jam për këto skena, se në fillim ta kam kërkue, sa anëtarë, se e pashë lojën që nuk jeni të interesuar me e bo, i keni votat edhe po na qitni në lajthitje. Unë për veti, personalisht po foli, jo në emër të grupit, unë i kuptoj lojnat edhe nuk deshta me hi. Ju i keni votat, nuk do ta votoni, do t'i ndërrojmë emrat, nuk do ta votoni, do të shkojmë qashtu, do të ankohemi. Jo, absolutisht, unë thashë veç në qoftë se duhet. Edhe, masi jam qetu në foltore, ta kam kërkue dje në mënyrë shoqërore, si shok, si mik, në Komitet, të kam thënë që, të lutem, bashkëpunimin qysh e lypi profesori, ta kam lyp unë dje. Mos e tolero drejtorin, se ai non-stop, ai me egon e vet krejt i injoron. Krejt janë të padijshëm për të, me krejt i merr personale. I vetmi drejtor që edhe mandatin e kaluar na ka ofendue, Uranin po e ofendon për këtë, mu më ka ofendue edhe në personale, bre, në familje. Po ai është i dobët, bre. Unë të kam thënë, mos e tolero, si ish-kryesuesja që e ka tolerue me ofendue. Çfarë të drejte ka drejtori i Ekonomisë për komisionin. Ai del nesër, qe tash kam me ia lyp listën e pronave, le të del, le të arsyetohet. Kur duhet për ekonomi, në rregull, ama me dalë për një komision, drejtori i Ekonomisë për komisionin për hajni, në qoftë se ka ose në qoftë se pretendohet që ka. Mos, kryesues, të lutem, seriozisht të lutem. E di që je i ri, e di që ke presion, se prej atje ta bon 'unë...unë'. Të lutem, mos t'ia nisim prej seancës së parë, se katër vjet shumë gjatë janë.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, Artani nuk është! Edhe një propozim mundeni me e dhënë!

Zgjim Fejza: Emri i dytë është Granit Rifaj!

Resul Fetahu: Edhe një herë, pra, emrat e propozuar janë: Zgjim Fejza, Granit Rifaj, Uran Halimi, Afrore Vejseli dhe Usmen Baldzi. Atëherë, kush është për themelimin e këtij komisioni? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 7 vota për, 11 kundër dhe zero abstenim, nuk miratohen këta emra për formimin e komisionit. Në fillim është votuar komisioni për me hy si pikë në rend të ditës. Në fillim u votua për më hy në rend të ditës, tash u votuan emrat. Tani vazhdojmë në pikën e fundit: pikën eventuale. A do me e marrë dikush fjalën?

Artan Loshaj: Pasi jemi në eventuale, pyetja e parë – nuk pata, po për drejtorin, ta kam kërkue në seancën e parë, sot nuk e prune listën e lokaleve të Komunës që i menaxhon Komuna edhe që je

mbikëqyrës i këtyre pronave, i nderuar drejtor. E dyta, një pyetje ia vona kryetarit, për kolegët që jemi me dy vende pune, çka do të ndodhë me këta, se unë e kam dorëzue mandatin, ma kanë kërkuar me e dorëzue se është e jashtëligjshme, thashë edhe ma herët, nuk mora përgjigje. Në qoftë se punojnë të tjerët, nuk jam kundër, nuk e kam personale, në qoftë se punojnë edhe të tjerët pa paga, human, kam punue dy vjet Nënë Terezë, po due edhe prapë me u kthye në punë, me dhënë shërbim për qytetarët. Thjesht, një përgjigje. E treta, po e shoh Tv Opojën shumë mirë, nuk e pashë Radio Sharrin. A e ka ndërprerë kontratën, a ka pas ndonjë dokument që është i sëmurë, a? Kontratën e keni me Radio Sharrin për me na përcjellë seancat këtu. Kryetar, e di që i ke tetë drejtorë, veç një po ta shoh, edhe një qatë, qaj i riu, mirë është shumë. Kur po duhet me qenë këtu prezent, s'po t'i shoh, a kur po duhet me u përzie në kompetencat tona po çohen këta drejtorët tu, këta smart drejtorët, bajagi diçka s'po më pëlqen. Po nejtë, po dalim te ato më seriozet, kryetar. Pyetja e parë e imja edhe e qytetarëve është – edhe është për të mirë, se më një intervistë, me 20 janar, në Tv Prizren e ke dhënë një deklaratë publike. Tv Prizrenin, e dëgjova unë, 20 janar, e pashë në Youtube, kryetari i Komunës, nja 5 minuta e kishe pas prezent Tv Prizrenin këtu. Edhe kishe diskutue që ke buxhet të mjaftueshëm për 2026-tën, e ke Grantin e Performancës 1 milion e 400 mijë – po më vjen shumë mirë edhe të përgëzoj – ke delarue që këtë mandatin e dytë ke me e bo krejt infrastrukturën me ndriçim edhe me kubëzim. Edhe, kishe thënë aty që nja 5-6 fshatra kanë mbet pa ndriçim, e ke me bo këtë vit. Po më vjen shumë mirë. Por, kur i kanë dëgjue këto fjalët disa qytetarë të Komunës së Dragashit që jetojnë në qytezë, kanë kërkuar që edhe ndërtesat kolektive – e kemi një tender 50 mijë euro këtë vit me e bo renovimin, ta kam kërkuar që më 50 mijë 12 ndërtesa nuk bëhen, me siguri që për 2027-tën ke me nda mjete edhe ke me bo mirë për qytetarët. Kërkesa e qytetarëve është shumë e thjeshtë, edhe pasi kanë fshatrat Xërxe, Zlipotok, Radeshë, është mirë krejt me pas ndriçim. Ndërtesat kolektive nuk kanë ndriçim, kryetar, edhe njëfarë meremetimi – ka jetue, drejtori ka qenë ish-banor i këtyre ndërtesave, e di shumë mirë gjendjen e tyre. Është mirë që në emër të qytetarëve, shuma nuk është shumë e madhe, me 20-30 mijë euro mundesh me i mbulue krejt, ndriçimin me jau bo ndërtesave edhe njëfarë meremetimi me e bo. Këtë ta kam kërkuar, se janë mbi 140 banesa, afër 150 banesa aty që jetojnë 150 familje, ta kam kërkuar edhe para dy viteve, edhe ta kam prurë një dokument se si Komuna e Prishtinës që e menaxhoni ju si LDK, e ka bo, i ka rregullue ndërtesat e vjetra, se prej viteve 60-70 këtu nuk ka pas meremetime. Ta kam prurë edhe modelin qysh, ata ku kanë pas vend edhe për lifta kanë bo edhe lifta, edhe njëfarë participimi kanë participue edhe qytetarët. Secila ndërtesë e ka orën e vet edhe pesë-gjashtë drita,

një ndërtesë nuk harxhon sa një dritë që harxhon në Xërxe ose në Kërstec. Kjo është veç në vullnetin tënd. Me qenë vullneti juaj i mirë, edhe besoj që e bojsh se ke premtue, është mirë që këtë vit me e bo këtë. Edhe, kërkesa ime e dytë është për pacientët e dializës. Edhe për këtë kam diskutue më herët, po kurrë nuk kam marrë përgjigje. Sa e di unë – po më vjen keq, se me diskutue shumë për pacientët me dializë me ty nuk mundem, se je mjek edhe shumë mirë e kuptojsh gjendjen shëndetësore, por mu më intereson gjendja e tyre e transportit. Përpara në Komunë të Dragashit – unë jetoj qe 30 vite këtu, këtu pacientët i kanë transportue punëtorët e QKMF-së. Tash po e bëjnë të Komunës, është në menaxhimin e juaj, nuk është problem ajo punë, nuk dua me hy andej. Mu më intereson veç transporti i tyre, se ata tri herë në javët shkojnë në Prizren, është transport i gjatë. Ke fillue shumë mirë, prej Krushevës vjen kerri, njëri kerr vjen prej Krushevës, e merr atë zotëriun në Krushevë, është për t’u përshëndetur, po më vjen shumë mirë – por kur vjen te Orqusha, a ka mundësi me u kthye edhe në Orqushë me e marrë një grua, se ajo del në të ftohtë e në të nxehtë, në acar, në mëngjes e masdite, del në rrugën kryesore, edhe po i bëjmë padrejtësi. Ai merret si zotni, vjen, ky tjetri pret në rrugë. Tjetra – Ramia – me emër po e them, se e kam mik, i Radeshës, punëtor i juaji, vjen prej Radeshës, e merr kerrin në Dragash, nuk i merr pacientët, tre të Lubevishtit, nuk i merr dy të Shajnes, e merr kerrin edhe vjen në Bresanë edhe në Zaplluxhe, i merr pacientët. Shumë mirë, në secilën shpi, është mirë nga një shofer personal me e pas ata. Ama, po më vjen se po i anashkalojmë, bre kryetar. 150 herë e kam bo në mend unë, se 26 vjet kam punue, i bjer me shkue në Prizren e me u kthye. Familjarët e tyre subvencionohen, për Shajne dhe për Lubevishtë, 350 euro. 150 herë, 300 euro subvencion, 2 euro në ditë me u çue një familjar, me çfarë gjendje shëndetësore është i familjes, edhe çohen në ora 06:00, është në punë ose nuk është në punë, e prish gjumin, edhe e bjer para QKMF-së, edhe e pret kerrin deri të vjen prej Krushevës, futet në kerr edhe shkon në Prizren, edhe vjen i lodhur, edhe familjari duhet me e lënë punën ose me e marrë taksin edhe me e prit qetu? Përpara s’kemi pas mundësi, i kemi subvencionue krejt, tash po e bëjmë. Është mirë me e shqyrtue me drejtorin, me nënkryetarin – se e di që keni vullnet, po nashta të ka ikë kjo – edhe me shkue me i marrë ata pacientët nëpër shpia, edhe mos të bëjmë standarde të dyfishta. Edhe një pyetje tjetër: Këta që shkojnë në dializë, edhe që merren prej vendit aty, a subvencionohen prej Komunës të gjithë, apo subvencionohen veç ata që bëjnë transport. Se unë sa e di, edhe merret pacienti – me emër nuk po due se po më vjen keq për gjendjen shëndetësore të tij, ishalla asnjë në familje nuk e kemi – edhe merret prej shpisë, edhe kthehet, edhe subvencionohet. E, tre të Libevishtit, një i Orqushës edhe dy të Shajnes, familjarët e bien para

QKMF-së, e bien në mes të rrugës, edhe qaty e lë, edhe duhet me shkue me 300 euro, e 350 euro. Kryetar, besoj që është shumë pak. Pse, bre kryetar, prapë në personale po e qesish? Po bën, se është standard i dyfishtë. Prej Krushevës zotninë e marrish me kerr vetëm, edhe e biesh deri në Dragash me i marrë pesë këtu. Ramia po të kalon nëpër Libevishtë, rrugën e re e kie, merre bre në Shajne edhe kalo këtu, kalo te Dëshmorët dhe bjer teposhtë. Është e ulët. Përpara na kemi qenë, e njëjta procedurë ka qenë, po të gjithë kemi udhëtue. Tash, pse dikush është në CDU – mos më shti tash personale me të sëmurit, ti po më thuesh plot rroga kie. Unë i kam rrogat për familjen time edhe nuk po jau vjedh ato. Ti i kek 12 milionë të buxhetit të Komunës së Dragashit e po të dhimën, kryetar. Mos e qit në personale, seriozisht e pata, nuk e pata për politikë. Këta të sëmurit nuk dojnë politikë, kryetar. Mos i personalizoni, ta ka dhënë virusin drejtori me i acarue sendet. Largohu 1.5 metër, se po të infekton me virus, nja 3 metër largohu prej drejtorit. Krejet në personale po e qitni.

Uran Halimi: Realisht, unë po kënaqem kur po ju shoh të nënshtruar kështu, po më bëhet zemra mal. Jo që keni me i ik hajnisë, se nuk keni ku e fshehni, se publikisht kam ardhë këtu për me ftue prokurorinë që me e hetue komplet mirëmbajtjen e veturave që nga viti 2022 edhe në vazhdimësi. Çka më bëri përshtypje është që, javën që po ikën – media, nëse mundeni me e fokusue këtë foton – javë që po shkon është dëmtue një veturë e urgjencës, i nderumi kryesues. E hulumtova rastin, në polici nuk është i lajmëruar fare. Është zhduk vetura prej këtu pari edhe ka shkue në mirëmbajtje, në rregullim. Kam edhe foto tjera, nëse doni jau servoj, se do t’ua servoj edhe organeve të drejtësisë. Kryetar, është shoferi juaj, i qeverisjes suaj, është punëtor i QMF-së. Ishalla, po lutem që s’ka pas pacientë edhe në të, se në vend që me e shnosh ju veç e dëmtoni hala ma shumë. Tjetra, Samidin, m’i përmende ti do komisione, mirë që nuk i kemi vazhdue se kish dalë faqe e zezë. A po e dish pse? Se këtu janë marrë rroga pa ardhë në Kuvend hiç. A e dish çka kishim zbulue? Ti e dish shumë mirë çka kishim zbulue, po mos i trazo ato. Jo, unë nuk i kam fsheh krimet, unë jau qes krimet se janë argumentet. Ato krimet ju dalin, mos u mërzitni për atë. Mandej, unë po e shoh punën e juaj të mirë, kundër të vërtetës, edhe çka keni me thënë për këtë rast? Policia duhet me e ditë, policisë nuk bën me iu fsheh, a është aksident a vetaksident, a ka pas pacientë në të, duhet me hulumtue na edhe këtë çka ka ndodhë, duhet dikush me dhënë përgjegjësi. Vetaksidenti lajmërohet në polici, rruga ligjore është. Sidoqoftë, konsistencën edhe përkrahjen për punë të mira, e kanë pas këta kolegët këtu, qe katër vjet, e kanë keqpërdor përkrahjen time. E dish shumë mirë qysh kanë rrjedhë sendet, i nderumi profesor. Por, prapë se prapë, sa i përket punëve të mira, këtu jam. Kjo ishte njëra prej punëve të mira që deshta me e ndërmarë. Mos mendoni që

keni me e fsheh, me votim ose mosvotim. Ju nuk jeni duke e votue listën e anëtarëve, komisionin e keni votue, me ose pa dëshirë. Por, prapë se prapë, kemi me vazhdue me procese tjera, patjetër që kemi me i njoftue edhe organet kompetente. Shpeshherë mendoj që ia vlen me ndejt në këtë Kuvend edhe me diskutue, edhe me punue për të mirë të qytetarëve. Shpeshherë më zhgënjani shumë, se nuk e dini edhe pse keni ardhë ju, të nderuar delegatë, këtu. Po sidoqoftë, unë këtu jam edhe këtu kam me qenë. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Në cilësinë e anëtarit më të vjetër të kuvendit të komunës, pasi e kam udhëhequr fillimin, ndonjëherë duhet të paraqitem përsëri, sepse jam sërish më i vjetri. Miq, ne e kemi pranuar këtë komision, kemi votuar dhe ky komision nuk kërkon asgjë të keqe. Supozimet ose paragjykimet janë diçka tjetër. Mendimet dhe qëndrimet janë diçka më e madhe. Ne nuk kërkojmë asgjë kundër opozitës në këtë rast, siç po e shoh, duhet ta them kështu – asgjë të keqe. Nëse çdo gjë është në rregull, pse të mos jeni edhe ju anëtarë të komisionit? Ju lus, s'ka nevojë për kundërshtime.

Edhe po të ketë, mos e dhëntë Zoti, diçka të keqe, edhe ju do ta hiqnit një pjesë të përgjegjësisë nga vetja. Të gjithë jemi delegatë, ne nuk i dimë të gjitha se çka mund të ndodhë ose të bëhet. Ja, shikoni, sapo e pashë këtë veturë. Nëse aty ka pasur edhe pacientë, ndërsa vetura është shtetërore... Ju mundeni – kemi përvojë, kemi vite – të shkaktoni një aksident privat, ta fshehni veturën ose, edhe më keq, të mos e njoftoni policinë, ose të merreni vesh me policinë që ta mbani në heshtje. Dhe pastaj, del që je fajtor, por nuk është problem, paguan vetë, s'ka procesverbal, s'ka gjobë. Mundet kjo. Por me veturë të shtetit kjo është shumë. Është tejkaluar çdo masë.

Në këtë kuvend, opozita nuk do të heshtë. Ta keni të qartë – ju nga pozita jonë joshumicë në komunën e Dragashit. Kjo opozitë joshumicë në këtë kuvend nuk do të heshtë. Sidomos ndaj jush. Por unë nuk mundem nga shumica e LDK-së që më sulmon se gjoja jam kundër tyre. Jo, unë nuk jam kundër Kosovës. Por kundër lojërave dhe lojëzave jam. Dhe do t'i luaj deri në fund.

Gjithë kohën e dëgjoj pozita kshtu opozita ashtu. Qëllim më të mirë sesa ai i opozitës sot në Dragash nuk kam parë. Zotërinj nga pozita, ekziston edhe jeta jashtë parlamentit. Nuk është vetëm jeta parlamentare; opozita mund të nisë edhe në rrugë të tjera. Për më tepër, ka edhe organe të tjera, nuk është vetëm KSH, siç përmendi drejtori Qamil. Ka organe të kontrollit të buxhetit, qendra në Prishtinë. Ka edhe avokati publik që po punon mirë këto ditë në Prizren. Mos të lejojmë, njerëz, të bëhemi shënjestër e tyre.

Sepse me këtë çështje mos mendoni që vetëm ne po dëgjojmë këtu. Kemi vëzhgues nga OSBE-ja, nga Bashkimi Evropian, kemi edhe media. Ja, s'ka media të komuniteteve pakicë, askush s'po flet, po e pres shumicën – hesht. Ah, po – s'qenka me rëndësi. Për mua s'ka problem, le të jenë pesë të shumicës. Për ju është problem, ju nuk e dini. Qytetarët tanë nuk e kuptojnë. Heshtni...

Mos e bëni këtë, njerëz. Profesor, nuk e dija, ju respektoj, por nuk e dija. Le ta lëmë pak kuvendin të punojë, e komuna të zbatojë vendimet dhe dëshirat e kuvendit. Kjo është emokracia.

Shukri Myrtezani: Po ndërlihem prapë, sa po ma forcon bindjen hala ma shumë për mos me e votue këtë komision, Uran. Në rast se ti e ke pas një komision, edhe e ke ditë që në fund po të del zi e ma zi, edhe e ke ndërpre, nuk ke të drejtë morale me kërkue komision. Nuk ka me u tërhek mbrapa. Në qoftë se e formon një komision, pa marrë parasysh qofsha unë apo ai tjetri e ky tjetri, duhet me i shkue deri në fund. Po ti, në qoftë se don me dalë shumë i sinqert edhe shumë i drejtë, më së miri se prokuroria që ta bën këtë punë edhe me dalë ti faqebardhë, me dalë këtu me dokumente, edhe me e paraqit ti atë keqpërdorimin që po thuesh – që unë nuk po e shoh, për shkak se ka shkue në mënyrë ligjore procedura, edhe me siguri do të kishte pas ankesa në qoftë se ishin shkelur procedurat. Me sa e di unë, sa e kuptova, nuk ka pas ankesë te shpallja e procedurave, te tenderi. Kështu që, nuk po më lë me kuptue që ka pas dallavere. Në qoftë se ka pas në legjislacionin e kaluar, unë nuk kam të drejtë me u përzie atje. Po flas për këtë legjislacion që jemi. Tjetra, unë e përkrah z.Loshaj, edhe i bëj thirrje kryetarit, jam me ta. Në qoftë se një mundësi me të vogël ka për ata pacientë – se unë e di që kryetari është shumë human edhe ne krejt e dimë se sa i ka ndihmue kësaj zone edhe sa iu ka ndihmue njerëzve, ditën e natën – Shpresoj që të bëjë një zgjidhje edhe për atë. Uroj që të mos ketë askush prej nesh familjaë, por ata që janë, i bashkohem, edhe duhet me bo çmos kryetari, një mundësi më të vogël në rast se e ka, ligjore edhe financiare, le t'i përfshin të gjitha ata pacientë që t'i kryejnë shërbimet dhe t'u lehtësohet barra e familjes. Unë e di vetë – i kam pas dy prindër – e di çfarë ngarkese është për familjarët. Kështu që, sinqerisht po them, ishalla ka mundësi ligjore, po besoj që nëse ka kryetari mundësi ligjore dhe ka mundësi financiare, ka me e bo këtë punë. Kështu që, për këso sende jam mbrapa, Uran. Lëne atë komision! Në rast se ka, vazhdo, i ke krejt dokumentacionet, kapi dokumentacionet, e dish ku është vendi, mos e maltreto as veten, as neve. Ecim me procedurat! Faleminderit!

Uran Halimi: Mu, profesor, po më pëlqen shumë që po ka replika. Faleminderit shumë, kryesues, që je shumë tolerant në këtë aspekt. Nëse më ke dëgjue krejt në fillim, kam akuzue për centiratje të tenderit, nuk kam akuzue që tenderi është i manipuluar në aspektin ligjor, po thashë u centirat.

Edhe kam akuzue për vitet e kalume, se kam bo kërkesë – ti nuk ke qenë, i nderumi profesor – zanafilla është pak më herët, bon vaki e dhjeta herë që unë e kërkoj formimin e këtij komisioni. Edhe, çka të them unë, pse qeky ngurrim, mu vetëm qeky po më habit edhe po më bën kurioz hala ma shumë me kërkue. Kam me vazhdue me e kërkue këtë komisionin, krahas kësaj kam me punue në atë drejtim, për sanimin edhe parandalimin dhe dënimin – nëse ka – të akterëve. Mirëpo, kriteret që janë kërkuar në atë tender – nëse nuk e ke, ta dërgoj, profesor – kriteret banale, të ulëta, janë qesharake. Sidoqoftë, ngurrimi juaj kaq i madh për mosformimin e këtij komisionit, mu po më bën hala ma shumë insistues, kam me qenë insistues. Ka me u bo, se është bo, veç emrat kemi me i ndërrue. Komisioni është votue, edhe me një votë të pozitës. Faleminderit, i nderumi Samidin! Komisioni është votue, veç kanë me u ndërrue emrat. Faleminderit shumë!

Vezir Reshiti: Deshta me u ndërlidhë me Artanin. E dha një propozim shumë të mirë, për Dragashit. Mendimi um është, Dragashi do me pas ekstra buxhet se vendet tjera, se është qytezë. A për këto tjerat, që po bëjnë politikë, duhet me qenë edhe ju kundër. Këto janë politike. A Dragashi do një buxhet më ekstra, se është qendër e të dy komuniteteve. E këso sende, këso masalla politike, këto edhe ju vetë nuk i përkrahni.

Artan Loshaj: Nuk pata me dalë, po faleminderit prej dy kolegëve, ishalla nuk është politikë, se thashë që me sëmundje nuk bëhet politikë. I nderuar kolegë asambleist, profesor, është shumë e lehtë, se unë të thashë, reagimi i kryetarit, për të mirë e kam, se i kam thënë në fillim që ky mandat është i fundit edhe kam me u mundue jo shumë me bo politikë – najherë kur duhet naj spec e qesim – po 90% kam me qenë shumë transparent. Absolut jo, me sëmundje jo, se punëtor shëndetësor jam. Është një problem, i ka nxit deklarata e kryetarit, që është pozitive ndaj qytetarëve, unë po e falënderoj, s'po e akuzoj. Është shumë pozitive, i ka nxit ata me lyp ma shumë. Kryetar ka thënë 1 milion e 400 mijë i kam veç Minisria që i ka lëshure, Grantin e Performancës. Qat problemin e pacientëve me dializë, është shumë i thjeshtë, se këtu jetoj edhe kam punue, nuk jam më i mençur se ju – punëtori vjen prej Radeshës. Në Radeshë, ku kthehet për Libevishtë, i ka 300 metër vijë ajrore. Veç vullnetin duhet me e pas drejtori, se kryetari bon vaki nuk e ka ditë këtë se nuk mund me i përcjellë krejta. Vjen këtu, e merr kerrine dhe shkon në Bresanë, mirë shumë – unë çdo send kam me ia votue kryetarit në qoftë se është për të mirën e qytetarit – edhe kalon nëpër Shajne, e merr pacientin edhe del poshtë, e kthejsh. Prej Krushevës po vjen shoferi, shumë mirë, se ai i nderumi 20 vjet është në dializë. Ka udhëtue prej Krushevës, i ka bo zgjidhje, është shumë mirë kjo. Sa për te Veziri, kolega, është shumë reale kjo. Ne jemi taksapagues të kategorisë së parë në

qytezë. E dyta, jemi dy-tri komunitete. E treta, janë dymbëdhjetë hyrje. E katërta, janë 150 familje. E pesta, nuk jam kundër, kemi prit Xërren, Kërstecin me u bo, ma larg, Zlipotokun, me e bo ndriçimin. Ka ardhë puna me e kërkuje edhe na. Është shumë e thjeshtë, drejtori ka qenë vetë banor i ndërtesës. Gjashtë drita, ora, pesë euro nuk i harxhon. Po banesat kolektive, kur jemi në kolektiv kërkush nuk do me i mirëmbajt. I kam dhënë propozim kryetarit, para dy viteve, nuk është kjo tash. O kryetar, qe bre Përparim Rama qysh e ka bo modelin, pesë euro e ka dhënë një taksë për mirëmbajtje. Në qoftë se ka investue komuna, për mirëmbajtjen e 20 ndërtesave që jemi, ka 5 euro mujore ia qesish taksën. Është mirë, ka ardhë koha më me e bo, kryetar. Veç i duhet vullneti. Pare ka, me 30 mijë euro dritë e bën Dragashin. Një ndërtesë harxhon sa një dritë Blaç-Zaplluxhe. Qekaq është e thjeshtë, veç vullneti i kryetarit, nuk i ka shkue mendja, se e di kryetari që e bën këtë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Atëherë, sa i përket pyetjeve që i parashtruat ju delegatët e Asamblesë Komunale, ju falënderoj për këto sugjerime edhe pyetje! Sa i përket ndërtesave, nuk e di a e ke votue apo jo buxhetin, po është miratue buxheti. Votën pro apo kundër, qysh e ke pas, nuk e di. Po, kryesore buxheti është miratuar. Edhe, në buxhetin e këtij viti edhe në dy vitet e ardhshme, janë paraparë mjete për renovimin e këtyre ndërtesave. Kështu që, ne do ta fillojmë këtë vit, ishalla qeveria qendrore konstituohet, edhe Kuvendi, miratohet buxheti, edhe na sa më shpejtë që të miratohet buxheti do të fillojmë me këto punë, sepse deri më sot është duke na u lëshue vetëm 1/12 e buxhetit. Kështu që, këto nuk jan kërkesa të juaja, askush nuk duhet me u mburrë, por është kërkesë edhe projekt i qeverisë së kalume që kam qenë unë kryetar. Ne do t'i bëjmë ato ndërtesa, një herë së pari do t'i renovojmë kulmet, sepse ato janë më urgjente. Edhe, për Dragash, në këtë mandat do të ndajmë më shumë mjete se herave të kalume. Ta kemi në qendër të vëmendjes investimet brenda në qytezën e Dragashit. Ju duhet që ta dini të gjithë se edhe banorët e Dragashit janë pak më të privilegjuar se ata të fshatrave. Arsyeja është se të gjitha institucionet komunale i kanë këtu, e kanë QKMF-në, e kanë Gjimnazin. Kështu që, në katër vitet e kaluara më shumë kemi qenë të orientuar në fshatra, me çue ma shumë investime, kështu që në këtë mandat do të ketë më shumë investime në qytezën e Dragashit. Sa i përket ndriçimit të hyrjeve, këtë vit ne nuk mund ta bëjmë, për arsye se buxheti është miratuar. Por do ta shohim, nëse nuk kushton shumë, nëse mujm me e bo me Mallra dhe Shërbime, e bëjmë, mundemi këtë vit të dy-tri ndërtesave, vitin e ardhshëm ndërtesave tjera. Ne veç kemi fillue me investue nëpër këto ndërtesa, i kemi ndreq do dyer, i kemi ndreq do dritare, por do të vazhdojmë të punojmë në Dragash. Sa i përket pacientëve të dializës,

askush me i ndijshëm se unë, si mjek, nuk është, për pacientët në përgjithësi, e sidomos këta të dializës edhe ata që janë me kancer. Unë, pre se kam ardhë kam fillue me nda subvencione, nuk janë paratë e mia, të qytetarëve janë. U janë ndarë subvencione të gjithë atyre që aplikojnë edhe lypin subvencione, që janë pacientë e dializë. Por, ata tek të cilët nuk mund të shkojë automjeti, ne u ndajmë më shumë mjete për mbulimin e shpenzimeve të transportit. Unë me sa e di, të gjithë pacientëve me dializë, këto katër vitet e fundit iu kemi nda mjete. Edhe, asnjë nuk ka ardhë me u ankue te unë, përveç një pacienti të Libevishtit, më duket. Nuk ka mundësi, momentalisht, mundësi organizative QKMF-ja e Dragashit, që me shkue të gjithë pacientët me i marrë nëpër shpia. Arsyeja është se duhet me i pas ndoshta 10 kerra, 10 vozitës. Edhe nëse, për shembull, fillojmë me shkue me i marrë nëpër shpia, ai vozitësi duhet me u çue në syfyr, me u nis me shkue me i mbledhë pacientët. Kështu që, kur po e përmend Krushevën, e ke ndoshta edhe një arsye pse e përmendish. Krusheva është fshat nëpër të cilin kalon rruga regjionale, edhe për arsye aty fillon mbledhja e pacientëve të dializës edhe vazhdon deri në Dragash. Menaxhmenti i QKMF-së në Dragash, bashkë me mu, bashkë drejtorin e ri që e kemi zgjedhë, do ta shqyrtojmë këtë mundësi. Nëse nuk mundemi të gjithë, do të fillojmë gradualisht, vit pas viti, ditë pas dite, që ta gjejmë formën më të mirë të mundshme për transportin e pacientëve në dializë. E përmende Përparim Ramën edhe thaje ta kam pru një model. Mu nuk ma ke dhënë. Mu ai dokument nuk më ka ardhë edhe nuk ma ke dhënë asnjëherë, se unë mbaj në mend, memorien shqyr Zotit hala e kam mirë. Nuk ma ke dhënë, po nëse e ke mundesh me ma pru, nuk është problem, munden me na shërbye si model qysh me e zgjidhë problemin e ndërtesave kolektive. U përmend nga një asambleist dëmtimi i automjetit të ndihmës së shpejtë. Nuk ka ndodhë para një, dy ose tri javëve, ka ndodhë para tre-katër muajve. Ky ka qenë një vetaksident. Personi i cili e ka bo këtë dëm, menjëherë i është lajmëruar menaxhmentit të QKMF-së, dhe menaxhmenti i ka ndërmarrë të gjitha masat ligjore për këtë çështje, edhe janë marrë edhe masa disiplinore ndaj këtij vozitësit. Me sa e di, unë atij i është ndaluar, nuk merret më me drejtimin e automjeteve të ndihmës së shpejtë, për shkak se ekziston rreziku që ai mund të bëjë prapë dëme dhe mund të dëmtojë edhe veten, edhe pacientët, po fati i mirë që atë ditë ai ka qenë vetëm, nuk ka pas pacientë dhe nuk ka pas persona të lënduar. E, sa i përket asaj se a është lajmëruar në polici a jo, unë këtë nuk e di, të drejtën ligjore a duhet a nuk duhet, por ajo është çështje që duhet të merret dikush tjetër. Por, megjithatë, nëse ligji thotë që edhe te vetaksidentet duhet të lajmërohet policia, ai nëse nuk u lajmëruar ka bo gabim. Edhe, nëse ky rasti po dihet, policia le të ndërmarrë masa ligjore ndaj atij personi, se unë nuk i mbroj ata. Po

aksidente ne kemi bo krejt, jemi shoferë të gjithë, edhe ishalla kërkush nuk ka me pas tash e tutje aksidente, po shyqyr Zotit që nuk ka pas të lënduar edhe nuk ka pas viktima. Prapë u përmend edhe puna e komisionit. Siç e dini ju, u votua që kjo pikë të futet në rend të ditës për t'u shqyrtuar. Edhe ju të gjithë e dini që as unë, si kryetar i Komunës, nuk kam të drejtë me iu përzie Zyrës së Prokurimit në punën e vet. Edhe Asambleja Komunale nuk ka të drejtë me formue komisione dhe me e vlerësue punën e tij. Punën e komisionit, me ligj, e vlerëson OShP-ja. Në këtë tender, kur është shpallë, ky është shpallë vitin e kaluar, kanë konkurruar tri kompani. Kanë qenë të parapara diku afër 80 mijë euro, është tender dyvjeçar. Kompania të cilën ti e përmende, që ka konkurrue me 30 mijë euro, me ligj, ajo nuk ka të drejtë me konkurrue nën mesataren e mjeteve të parapara. Komisioni për vlerësim shumë ka qenë shumë komision ekspertash, edhe ia ka dhënë kompanisë së tretë, më duket, apo të tretë, nuk e di. Unë tadh dëgjova prej teje, veç e di që është lidhë marrëveshja. Por, asnjëra prej këtyre kompanive nuk është ankue në OShP. Arsyen pse nuk janë ankuar, ata e dinë vetë. Sigurisht, dokumentacionin nuk e kanë pas të kompletuar. Kështu që, për këtë çështje – e përmende edhe transparencën – po të them që unë, çdo vendim që bie si kryetar i Komunës, të gjitha vendimet në dy gjuhë i publikojmë në uebfaqen e Komunës, edhe çdokush mundën me hy e me i pa. Po ashtu, edhe Zyra e Prokurimit, qe katër vite, asnjë gabim Zyrës së Prokurimit Auditori i Jashtëm edhe i Brendshëm nuk ia ka gjet. Është një prej zyrave më të mira, ndoshta në Kosovë. E di që gjatë mandatit të kaluar ke çue shumë lëndë në prokurori, ti apo kush i ka çue nuk e di. Por, ndaj asnjëres lëndë deri më tani nuk është ngrit asnjë aktakuzë, asnjë i dënuar. Jemi qeveri që kemi punuar me duar të pastërta. Sa i përket transparencës, ti ke të drejtë, ligji ta lejon me kërkue qasje në dokumente zyrtare. Mundesh me kërkue, edhe qato dokumente çoi në prokurori, edhe për këtë çështje le të merret prokuroria. Këtu asnjëri nuk është ekspert me e vlerësue punën e Zyrës së Prokurimit. Përveç OShP-së, ajo ka të drejtë, edhe prokuroria dhe organet e hetuesisë. Kështu që, është mirë ti, masi e ke vazhdue këtë, edhe unë do të jem përkrähësi yt. Nëse prokuroria gjen ndonjë shkelje, unë menjëherë do të kërkoi masa disiplinore, ligjore dhe administrative, ndaj personit që e ka bo një gjë të tillë. Sa i përket rrogës primare dhe sekondare, ju e dini që Samidini është njëri prej atyre, edhe ai nuk e ka të obliguar me shkue me dhënë deklaratë që po pranon këtë apo atë, për arsye se Samidini veç edhe dy vjet shkon në pension, kështu që këtij nuk ka nevojë me iu rujt vendi i punës. Ky është përcaktuar për rrogën për Asamble Komunale, ti je përcaktuar po ashtu për rrogën për Asamble Komunale, edhe unë të garantoj që ka me u zbatue ligji. Samidini nuk planifikon më me u kthye në vend të punës, sepse ky shkon në

pension. Kështu që nëse e marrish lidhjen time me vëllaun, Samidini don me e përfundue këtë mandat me mandatin e asambleistit. Me të njëjtin asambleist unë e kam pas një takim dje me të, unë i kam sugjerue asaj me e zbatue ligjin. Tash është çështje personale e saj, ajo ka mundësi e zgjedh Asamblenë, ka mundësi e zgjedh punën. Ajo do ta marrë një vendim, ose do të jetë asambleiste, ose do të shkojë në punë. Kaq! Ti e ke bo më herët, por Samidini munden mos me e bo. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, nuk ta kam përmend emrin dje te vëllai, se e dish çfarë raporte kemi edhe nuk due, jo që frikësohem, po nuk më pengon. Unë kam thënë, në qoftë se ka mundësi, i ke dhënë mundësi jashtë ligjit, me punue në mënyrë humanitare – nuk thashë me dy paga, se ata në qoftë se e bëjnë, e shkelin ligjin – në qoftë se bëjnë në mënyrë humanitare, po due edhe unë me punue pa pare, nuk ka të keqe kurgjo, publikisht po them. Nuk lejohet, e di, për atë edhe unë e kam bo. Këta hala janë duke punue, ajo deri dje ka qenë në pushim vjetor. Absolut, s’po më intereson! Për te ndërtesat, kryetar, më vjen mirë edhe po presim, se të kanë dëgjuar qytetarët edhe e di, kur ta premtosh, besoj që e bojsh. Por, te dializa më preke pak, se ka mundësi, kryetar. Nuk jam kundër – mos të bëj be në Kuvend – po si është e mundur, Rami Rashiti, 5 km i ka Radeshë-Dragash me ardhë me atë veturën, e mos me mund 500 m vijë ajrore me e marrë pacientin, tre janë në Libevishtë, dy minuta i duhen. Mos, se ofendohen qytetarët kur po thuesh duhet me u çue në syfyr. Nuk duhet syfyr, duhet dy minuta, qe ku është rruga. Vjen këtu, 500 metër e ke Shajnen edhe shkon kombi. Mirë po më vjen që ka mbrri në Zaplluxhe, shumë mirë po më vjen. Nuk po më intereson ajo pjesë që mund një shofer i Bresanës me shkue, mos me e çue Ramin me shkue n’5. Ajo është e juaja, nuk më intereson. Ke mund, qysh i ka vozit ish-shoferi, kolega jonë, prej Bresanës u çue në 06:10 e ka kallë kerrin, edhe e ka marrë në Bresanë e në Zaplluxhe. Mirë shumë! Ama, mos me e marrë në Libevishtë, mos me marrë në Shajne, dy edhe tre, janë pesë. Dy kerra i harxhojnë 100 km në ditë për tre veta, për pesë veta nuk je në gjendje 2 km me i bo. Shumë e lehtë është, o kryetar. Jo i Radeshës, shoferi po vjen prej Radeshës. O kryetar, nuk ka katunde, po a po maltretohet Ramia prej Radeshës e në Zaplluxhe, po ajo maltretim edhe për Ramin është. Qysh nuk qenka maltretim me shkue Radeshë-Zaplluxhe 25 km, e qenka matretim me shkue 500 metër! Nuk e kam personale, nuk e kam kurgjo, është i sëmurë. Del prej Orqushës në mes të rrugës e pret, nuk është mirë. Unë thashë, pa inate, kie mundësi, pare kie, vetura kie, punëtorë ke marrë plot, Grantin e Performancës e kie, nuk të kushton pale se sa. Hej, 50 km i bon me shkue me e marrë

një pacient, e nuk po i bojka 500 metër. Thuj nuk e kam vullnetin, mos i ndaj qytetarët, mos se ofendohen keq, kryetar, me u çue në syfyr, fjalë e rëndë është, tërhiqe! Faleminderit!

Samidin Xheladini: Për hir të së vërtetës, çështja e kësaj është personale, edhe e jemja. E dimë vetë më mirë. Çështja e rrogës primare dhe sekondare, Ligji i Pagave ka dalë para tri viteve, dhe unë atëherë jam përcaktuar. Edhe atëherë kur jam përcaktuar unë, 13 asambleistë kanë qenë me dy rroga. I vetmi unë që jam përcaktuar për rrogë primare Asamblenë. Të tjerët nuk janë përcaktuar edhe ajo është e drejtë e tyre. Unë kam dashtë me e lëshue një vend të punës, që dikush tjetër me e marrë një rrogë. Kam pas keqkuptime me zyrtarin, e që edhe sot nuk e di arsyen pse. Pastaj, pas një viti, Arijeta kur është bërë kryesuese, edhe ajo të njëjtin pozicion e ka pas. Më kanë thirrë në telefon, me kanë thënë me ardhë me e bo edhe unë sikur që kam kërkue. Unë kam ardhë e kam nënshkruar prapë. Vendimi i Arijetës u aprovue, i jemi nuk u aprovue. Para shtatë muajsh, zyrtari në fjalë më ka thirrë në telefon, më ka thënë çka po bojsh. I thashë pse, arsyen, ma ka përmend Baldzin, a me të drejtë a pa të drejtë, tha në qoftë se nuk përcaktohesh të humb vendi i punës. I thashë e di mirë, jam në dijeni të fortë për këtë punë. Unë jam përcaktuar për Asamble. Nuk ka pas nevojë më shumë me e zgjat. Në këtë rast, çdo njeri – këtu delegatë jemi – çdo njeri e di ligjin edhe çdo person duhet të përcaktohet. Tash, kryetari edhe mu më ka thënë – qe Ventaza ku është – a na ka thënë, Ventaza dje? Edhe plot herë të tjera. E drejtë e jemja është a përcaktohem, qysh përcaktohem, çka e keni gajle ju për atë punë? Nuk keni ju çka mereni me atë punë, kjo është çështje personale. Ju faleminderit!

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, e shpallim të mbyllur këtë seancë! Ju faleminderit për pjesëmarrjen!